

Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

PROJECT AGAINST CORRUPTION IN ALBANIA (PACA)

EDUKIMI KUNDËR KORRUPSIONIT MANUAL PËR MËSUESIT



Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

PROJECT AGAINST CORRUPTION IN ALBANIA (PACA)

Edukimi kundër korrupsionit

Manual për mësuesit

Tiranë, shtator 2012



Autorë:

1. Afërdita Mëhilli
2. Aida Serjanaj
3. Elida Shehu
4. Enerjeta Lacaj
5. Etleva Makri
6. Ermira Zeneli
7. Finali Rogo
8. Majlinda Zeneli
9. Manushaqe Hoxha
10. Silvana Avdulaj (Hysenbelliu)

Redaktor përgjegjës: Astrit Dautaj, IZHA

Ky manual është hartuar dhe botuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet e shprehura në të nuk duhet të interpretohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

TABELA E LËNDËS

1.	HYRJE	1
2.	KORRUPSIONI DHE ROLI I ARSIMIT NË PARANDALIMIN E TIJ	2
2.1	Çfarë është korrupsioni?	2
2.2	Cilat janë disa nga pasojat e korrupsionit?	3
2.3	Si luftohet korrupsioni?	4
2.4	A mund të parandalohet korrupsioni?	5
2.5	Roli i edukimit në parandalimin e korrupsionit	6
3.	DISA STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES NË KUADËR TË EDUKIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT	8
3.1	Shtjellim idesh	8
3.2	Njëri mëson tjetrin	9
3.3	Të pyeturit	9
3.4	Loja me role	10
3.5	Përdorimi i materialeve audio dhe video	10
3.6	Burimet në komunitet (bashkësi)	11
3.7	Të menduarit kritik dhe trajtimi i çështjeve kontradiktore	12
3.8	Studimi i rastit	15
4.	VEPRIMTARI PRAKTIKE	20
	Mësimi 1	20
	Mësimi 2	27
	Mësimi 3	29
	Mësimi 4	31
	Mësimi 5	33
	Mësimi 6	35
	Mësimi 7	37
	Mësimi 8	39
	Mësimi 9	41
	Mësimi 10	43
	Mësimi 11	45
	Mësimi 12	47
5.	ANEKSE	49
	Aneks 1: Fushat e veprimit të Strategjisë Anti-korrupsion të qeverisë shqiptare	49
	Aneks 2: Korrupsioni në legjislacionin shqiptar	53
	Aneks 3: Shembuj të integritit të mësimëve në programin e Klasave 8 deri 12	58
	Literaturë shtesë për luftën kundër korrupsionit - Për ata që duan të dinë më shumë...	60

1. HYRJE

Ky manual synon t'iu ofrojë mësuesve disa instrumente që u nevojiten për të përfshirë në mësim çështje që kanë të bëjnë me edukimin e nxënësve kundër korrupsionit, si një ndër dukuritë negative që pengon zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Ky edukim është mëse i nevojshëm, veçanërisht në vendet ku demokracia është ende e pakonsoliduar dhe ku mundësitë për korrupsionin duken se janë më të mëdha.

Ky manual është i ndarë në tre pjesë.

1. Pjesa e parë ofron një ide të përgjithshme për korrupsionin, për drejtimet kryesore të luftës dhe të përpjekjeve për parandalimin e tij.

Këtu theksohet roli i pazëvendësueshëm i shkollës në formimin e të rinjve, të aftë të marrin vendimet e duhura e të mirinformuar, si qytetarë të mirë në shërbim të luftës kundër korrupsionit dhe të parandalimit të tij.

2. Pjesa e dytë përmban disa prej metodave, strategjive dhe teknikave që përdoren më shpesh në fushën e edukimit ligjor dhe atij qytetar dhe për rrjedhojë edhe në fushën e edukimit kundër korrupsionit.

Strategjitë dhe teknikat e përzgjedhura në këtë pjesë nuk janë të reja. Ato gjenden pothuajse në të gjitha manualët e trajnimit që kanë në themel metodat ndërvepruese të mësimdhënies. Mësuesi është i lirë të zgjedhë metodat që mendon se përshtaten më mirë me mjedisin arsimor në të cilin do të zhvillojë veprimtaritë dhe me objektivat që synon të arrijë.

3. Pjesa e tretë e manualit përmban orë mësimore model në fushën e edukimit kundër korrupsionit. Orët mësimore janë zhvilluar dhe eksperimentuar nga mësues të lëndëve të edukimit qytetar, të qytetarisë dhe të lëndës së historisë e gjeografisë.

Këto orë mësimore janë thjesht modele të përfshirjes së edukimit kundër korrupsionit në klasa, në lëndë dhe tema të ndryshme. Si të tilla ato nuk trajtojnë të gjitha çështjet që lidhen me edukimin për parandalimin e korrupsionit, por shërbejnë për të nxitur imagjinatën dhe përvojën e pasur të mësuesit në kuadër të këtij edukimi.

Çdo mësues mund të zgjedhë të zhvillojë ato tema që mendon se i shërbejnë realizimit të objektivave që i ka vënë vetes në një orë mësimi, duke qenë i sigurt se ai do t'i pasurojë ato me shumë tema dhe veprimtari të tjera që mund të shërbejnë si modele për të tjerët.

Mësuesi duhet të bëjë kujdes që problemet dhe shqetësimet e korrupsionit të ngrihen në një kontekst të caktuar konkret, për shembull, kur trajtohen çështje ekonomike, juridike, mjedisore etj. në plan kombëtar, vendor ose shkolle. Kjo do të vendosë luftën kundër korrupsionit dhe edukimin për parandalimin e tij në një terren konkret e të prekshëm nga nxënësit. Në këtë mënyrë, ky edukim do të mund të arrijë objektivat e synuara.

2. KORRUPSIONI DHE ROLI I ARSIMIT NË PARANDALIMIN E TIJ

Korrupsioni është një ndër problemet kryesore me të cilët përballen shumë vende, veçanërisht vendet në zhvillim dhe ato që sapo e kanë hedhur pas të shkuarën autoritariste ose totalitare. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, korrupsioni minon institucionet demokratike, ngadalëson zhvillimin ekonomik dhe i bën qeveritë më pak të qëndrueshme, kurse Banka Botërore e ka përshkruar korrupsionin si një ndër pengesat më kryesore të zhvillimit ekonomik.

Korrupsioni është një problem që ekziston në të gjitha vendet, ndaj, për këtë arsye, të gjitha vendet duhet të forcojnë dhe përmirësojnë politikën, strategjinë, institucionet, kuadrin ligjor dhe përpjekjet konkrete të qëndrueshme për ta parandaluar dhe për ta luftuar atë. Disa nga krimet që lidhen me korrupsionin gjenden në të njëjtën kohë në legjislacionin e vendeve të ndryshme. Ndër to dallohen krime të tilla, si:

- Marrja, zhvatja ose dhënia e mitës.
- Menaxhimi i keq ose përvetësimi i pronave të shtetit.
- Përdorimi jo i ligjshëm i informacioneve shtetërore konfidenciale.
- Tregtia përmes ndikimit dhe përdorimi i saj për përfitime personale.
- Mashtrimi në zgjedhje dhe ndërhyrja në to.
- Përhapja e informacioneve të pasakta ose sigurimi i tyre për t'i çorientuar hetuesit.
- Pasurimi jo ligjshëm.
- Pengimi ose ndërhyrja në urdhrat shtetërore.
- Dënimi i personave, të cilët informojnë për sjellje të pahijshme të zyrtarëve
- Dëmtimi i shërbimeve publike

Përcaktimi i nivelit të korrupsionit në një vend është shumë i vështirë për t'u arritur. Megjithatë, ka të dhëna të ndryshme që të çojnë në përfundimin e pranuar gjerësisht se Shqipëria vuan ende nga nivele të larta të korrupsionit në shumë fusha. Kjo është një ndër arsyet që qeveria shqiptare e ka vendosur luftën kundër korrupsionit në listën e përparësive më të rëndësishme të politikës së saj. Kjo gjen pasqyrim kryesisht në strategjinë ndërsektoriale të luftës kundër korrupsionit dhe të qeverisjes transparente të qeverisë për vitet 2008-2013 dhe në Planin e veprimit të integruar kundër korrupsionit për vitet 2011-2013.

Megjithatë, duhet patur parasysh që jo gjithçka që shihet si korrupsion nga opinioni publik dhe media është, me të vërtetë, korrupsion. Ngjanjëherë, ekziston një perceptim i përciptë për arsyet, kushtet, pasojat e korrupsionit dhe rrugët për ta luftuar atë.

2.1 Çfarë është korrupsioni?

Në përgjithësi, korrupsioni përkufizohet si *shpërdorimi i pushtetit të besuar ose i funksionit publik për përfitim privat*. Ky përkufizim qëndron në themel të përkufizimeve ligjore të ryshfetit/mitës, të cilat ndeshen në shumicën e sistemeve

juridike në botë, përfshirë edhe atë shqiptar. Ky përkufizim nënkupton që korrupsioni ka të bëjë me marrëdhënie shkëmbimi individuale dhe se të dyja palët që përfshihen në të japin ose marrin ryshfete për përfitime me interes privat. Ky është edhe kuptimi i korrupsionit që gjendet në konventat dhe standardet ndërkombëtare të detyrueshme për korrupsionin, siç janë ndër të tjera, për shembull, konventat penale dhe civile të Këshillit të Evropës për korrupsionin dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Megjithatë korrupsioni është një dukuri shumë më e ndërlikuar se sa ajo që nënkuptojnë përkufizimet ligjore:

- Korrupsioni është një dukuri në të cilën njerëzit (edhe zyrtarët të cilët kërkojnë ryshfete) shpeshherë përfshihen jo vetëm me vullnetin e tyre të lirë, por edhe të detyruar nga pushtete më të larta, si në rastin kur vartësit detyrohen për kuota ryshfetesha nga eprorët e tyre.
- Korrupsioni, veçanërisht kur është mjaft i përhapur, mund të karakterizohet nga norma sjelljeje të cilat e justifikojnë dhe e përforcojnë atë, pra të kthyera në “kulturë”. Kur në të gjithë shoqërinë ose edhe në institucione të veçanta sundon ose ekziston kultura e korrupsionit, nuk mjafton vetëm heqja e stimuljeve që i përfshijnë njerëzit në korrupsion, për të ulur ndjeshëm nivelet e tij. Për shembull, nivelet e larta të korrupsionit mund të përforcohen nga prania në shoqëri e një kulture në të cilën ekziston dhe mbështetet “norma e reciprocitetit”, domethënë, ku shkëmbimi i ndërsjellë i favoreve, me kalimin e kohës, bëhet mënyrë mbizotëruese me anë të së cilës individët përipiqen t’i realizojnë nevojat dhe interesat e tyre. Në një kulturë të tillë, kjo mënyrë e plotësimit të nevojave dhe interesave vlerësohet më e rëndësishme se sigurimi i tyre përmes rrugëve zyrtare.

2.2 Cilat janë disa nga pasojat e korrupsionit?

Cilat janë disa nga pasojat negative të korrupsionit në shoqëri?

Pasojat në fushën ekonomike

- Në shtetet e korruptuara, komuniteti i biznesit duhet të ndajë disa nga fondet e veta për korrupsionin, gjë që shkurton investimet dhe prodhimin kombëtar bruto.
- Korrupsioni i zë frymën konkurrencës së lirë, në mënyrë të veçantë kompanive të vogla.
- Me rënien e konkurrencës, ulet edhe cilësia e mallrave dhe e shërbimeve.
- Ulen të ardhurat shtetërore dhe rritet ekonomia në hije (informale).
- Aty ku tolerohet korrupsioni, punonjësit civilë marrin të ardhura të vogla dhe mbi qytetarët e thjeshtë rëndon mita që ata duhet të paguajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre.
- Investitorët e huaj kanë më pak besim tek shteti dhe, për këtë arsye, kontributi i tyre ndaj ekonomisë së vendit bie.

Pasojat në cilësinë e qeverisjes së shtetit

- Ulet numri i investimeve publike dhe efikasiteti i ndërmarrjeve shtetërore.
- Fushat e aktiviteteve qeveritare dhe strukturat e shpenzimeve i nënshtrohen ndryshimit – zyrtarë publikë të korruptuar “miratojnë” projektet, të cilat garantojnë shuma më të mëdha.
- Egoizmi i zyrtarëve publikë lë në hije të menduarit strategjik në kuptimin e nevojave të shtetit, prandaj mungon vëmendja e duhur për problemet ekonomike dhe sociale.
- Ulet cilësia e shërbimeve publike.

Pasojat socio-politike

- Mirëqenia personale gjithnjë e më shumë vlerësohet më e rëndësishme se mirëqenia publike, e cila pothuajse lihet në harresë.
- Politikanët dhe punonjësit civilë fillojnë të keqpërdorin pozitën e tyre për të krijuar mirëqenie personale.
- Të rinjtë i shohin shërbimet civile si një mënyrë jetese sa e përshtatshme, aq edhe tërheqëse.
- Shoqëria e korruptuar nuk arrin të shohë as motivet e luftës kundër korrupsionit. Vetë njerëzit nuk arrijnë të dallojnë nëse:
janë të pakënaqur me praninë e korrupsionit si të tillë, apo me faktin që dikush tjetër dhe jo ata ka siguruar përfitime të mëdha ose më të mëdha?
- Niveli i korrupsionit mund të lidhet me kulturën, mentalitetin dhe traditat e një shoqërie të caktuar. Në shoqëritë ku korrupsioni gati për ligjet është shumë më e vështirë të ndryshohen veset e jetesës dhe të menduarit.
- Punonjësit civilë mund të demoralizohen nga pagat e ulëta, nga përgjegjësitë e punës që nuk kanë të bëjnë me llojin dhe cilësinë e saj, nga qëllimet jo të qarta të organizatës për të cilën punojnë dhe nga klientelizmi ndërmjet/midis eprorit dhe vartësit, etj.

2.3 Si luftohet korrupsioni?

Zvogëlimi i nivelit të korrupsionit nuk është një proces i lehtë as edhe i shpejtë në kohë. Ai lidhet me faktorë të shumtë historikë, ekonomikë e politikë të cilët veprojnë në shkallë, intensitete e forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Kohët e fundit nuk mungojnë edhe përpjekjet për të justifikuar aktet e korrupsionit, madje edhe për ta paraqitur atë të dobishëm për shoqërinë. Në këtë këndvështrim, sipas disa ekonomistëve dhe politikanëve, korrupsioni është i dobishëm sepse ai:

- lehtëson procesin e vendimmarrjes, pasi ai i “vajis” rrotat makinerisë së shtetit dhe rrit efikasitetin e ekonomisë;
- kursen kohë dhe meqë “koha është para”, ai kursen paratë e shtetit;
- transferon parimet e konkurrencës së tregut të lirë në fushën e strukturave shtetërore;
- kompenson të ardhurat e vogla të shërbyesve civilë, duke kursyer fondet buxhetore.

Meqenëse shkaqet e korrupsionit përfshijnë faktorë të ndryshëm të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë (përfshirë kryesisht politikat ekonomike të papërshtatshme, ndërjegjësimin dhe pjesëmarrjen e ulët të publikut, dobësinë e rolit të shoqërisë civile, mungesën e përgjegjshmërisë së institucioneve publike, vullnetin e dobët politik, kulturën apo mentalitetin e shoqërisë, etj.), lufta kundër korrupsionit duhet të ketë një përqsasje gjithëpërfshirëse¹.

Korrupsioni mund të luftohet në rrugë të ndryshme.

Njëra rrugë është të *luftosh* korrupsionin duke hetuar, duke arrestuar dhe duke ndëshkuar personat e përfshirë në të. Kjo kërkon të rriten kompetencat hetimore të policisë dhe të prokurorisë, të forcohen mekanizmat e inspektimit, të kontrollit etj. Kjo rrugë “shtypëse” mbështetet në idenë se korrupsioni është shkëmbim vullnetar i ndërmarrë nga pjesëmarrësit në të, për të realizuar interesat e tyre private. Ajo bazohet edhe në hamendësimin që ata që përgjigjen për kontrollin dhe zbatimin e ligjit (policia, prokuroria, etj.), nuk janë të korrumpuar. Por asnjëri prej këtyre hamendësimeve, në vetvete, nuk është i vërtetë, veçanërisht në vendet dhe në institucionet ku korrupsioni është mjaft i përhapur ose mbizotërues.

2.4 A mund të parandalohet korrupsioni?

Rrugë më të ndërlikuara të përballjes me korrupsionin janë ato që synojnë *parandalimin* e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, të sistemeve dhe procedurave të tilla që të jenë të afta, nga njëra anë, të pakësojnë sa të jetë e mundur faktorët dhe stimujt që i shtyjnë njerëzit, që punojnë në to, të përfshihen në korrupsion dhe, nga ana tjetër, të rrisin sa më shumë stimujt që i shtyjnë njerëzit të largohen prej tij. E thënë shkurt, parandalimi i korrupsionit lidhet me *qeverisjen e mirë*.

Megjithatë, fakti i përmendur më sipër, që njerëzit përfshihen në korrupsion të detyruar nga pushtete të caktuara ose nga kultura e favoreve (e ndereve) të ndërsjella, të çon në idenë që *qeverisje e mirë* nuk do të thotë, thjesht dhe vetëm, të ndërtosh institucione që synojnë të ndihmojnë njerëzit të shmangin korrupsionin për shkak të interesit të tyre privat. *Qeverisja e mirë* nënkupton ndërtimin e institucioneve, për të cilat njerëzit që punojnë të ndihen krenarë dhe në të cilat marrja me korrupsion të vlerësohet si diçka e huaj për konceptin e rolit të tyre publik, si shërbëtorë të popullit.

Një faktor i rëndësishëm i strategjive parandaluese është kundërshtimi, gjithnjë e më i qëndrueshëm, ndaj korrupsionit prej qytetarëve si përdorues të shërbimeve publike. Kjo kërkon që qytetarëve t’u sigurohet mundësia të njohin, jo vetëm të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe pasojat që sjell korrupsioni për shoqërinë dhe për ta si individë. Një gjë e tillë do të mund të ishte më e efektshme, nëse do të ishte pjesë e një politike më të gjerë, që krahas synimit për krijimin e një qytetarie të mirë, do të kishte si objektiv, veçanërisht në fushën e arsimit, që nxënësit të dalin nga shkolla me bindjen se kundërshtimi i korrupsionit shkon përtej interesit të tyre vetjak dhe bazohet në pikëpamjen e përbashkët për tiparet e kësaj lloj qytetarie.

¹ Shih Aneks 1, fushat e veprimtarisë së Strategjisë antikorrupsion të Qeverisë Shqiptare

2.5 Roli i edukimit në parandalimin e korrupsionit

Shkolla mund të luajë një rol themelor në kuadër të politikave kundër korrupsionit. Nga ajo kërkohet të ndihmojë brezat e rinj, nxënësit dhe studentët, për t'u bërë të aftë të përballojnë, me vullnet dhe sukses, trysnitë që i shtyjnë ata në pranimin e ryshfeteve, duke u përfshirë në praktika korruptive.

Njohja me të drejtat dhe interesat e tyre, i pajis nxënësit me aftësinë dhe pushtetin për të përballuar trysninë e dhënies dhe marrjes së ryshfeteve, edhe nëse kjo, në pamje të parë, duket në interes të tyre. Po kështu, ideja se qytetarët i kanë këto njohuri, i frenon zyrtarët të kërkojnë ryshfete.

Më tej, nëse qytetarët (dhe zyrtarët), si rrjedhojë e arsimimit të tyre, janë mësuar të vlerësojnë ryshfetin dhe praktika të ngjashme me të si të papajtueshme me rolin e tyre publik, si qytetarë ose zyrtarë, ata kthehen në pengesa të pakapërcyeshme kundër korrupsionit.

Edukimi kundër korrupsionit mund të luajë një rol vendimtar edhe në përpjekjet për të ulur shpeshësinë e kësaj dukurie tejet dëmtoese për shoqërinë shqiptare.

Synimet dhe mundësia e edukimit kundër korrupsionit në shkollë

Qëllimi i edukimit kundër korrupsionit, në përgjithësi, është që të ndërtohen vlerat dhe të zhvillohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për të formuar qëndrimin qytetar të nxënësve kundër korrupsionit. Ai synon formimin e një personaliteti të vetëdijshëm për kërcënimet që paraqet korrupsioni për mirëqenien publike dhe sigurinë shtetërore dhe të gatshëm për ta luftuar atë.

Në mënyrë të veçantë, edukimi kundër korrupsionit synon:

1. Njohjen e dukurisë së korrupsionit: thelbin, shkaqet dhe pasojat e tij;
2. Nxitjen dhe zhvillimin e qëndrimeve jotolerante ndaj korrupsionit;
3. Edukimin e vullnetarizmit për të luftuar korrupsionin;
4. Forcimin e aftësive të tilla, si:
 - aftësia për të komunikuar, për të gjetur, për të proceduar dhe për të transmetuar informacionet;
 - aftësia e të menduarit kritik dhe e zgjidhjes së problemit e çështjeve;
 - aftësia për të planifikuar dhe për të organizuar aktivitete;
 - aftësia për të menaxhuar kohën, burimet financiare dhe burimet e tjera;
 - aftësia për të menduar dhe për të vepruar në mënyrë krijuese;
 - aftësia për të ndërmarrë nisma, për të qenë i pavarur, për të marrë përsipër përgjegjësi për veprimet e dikujt;

- aftësia për të bashkëpunuar dhe për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore e konstruktive;
- aftësia për të marrë pjesë në jetën shoqërore të shkollës e të komunitetit etj;

5. Edukimin e vlerave të tilla si respektimi i vlerave demokratike, interesimi për gjithçka që ndodh, ndershmëria, përgjegjësia për veprimet dhe sjelljen vetjake dhe të tjetrit, vetëpërmirësimi i vazhdueshëm si dhe pasurimi i njohurive dhe aftësive shoqërore dhe kulturore, etj.

Edukimi antikorrupsion në shkollë mund të bëhet në forma të larmishme.

- Së pari, ai mund të përfshihet në objektivat e të nxëniet në kurrikulën e detyruar dhe në atë me zgjedhje, si në arsimin e detyruar, ashtu edhe në atë të mesëm.
- Së dyti ai mund të jetë pjesë e veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare, të cilat mund të zhvillohen në nivel klasë, shkollë dhe në nivel komuniteti shkollor (fushata qytetare, konferenca, veprimtari rinore, etj.)

Meqë synimi kryesor i edukimit kundër korrupsionit është formimi i vetëdijes qytetare, hapësira dhe mjedisi më i mundshëm i zhvillimit të këtij edukimi është ai i lëndëve shoqërore (qytetari, histori, gjeografi, ekonomi, sociologji, filozofi, etj). Hapësira të mëdha edukimi kundër korrupsionit gjen në lëndën e qytetarisë, e cila ka si synim kryesor formimin e qytetarit të aftë e të përgjegjshëm për fatet e bashkësisë ku jeton.

Integrimi i edukimit antikorrupsion në arsim nuk do të ishte i suksesshëm, nëse ai nuk do të vendosej në një kontekst konkret e real, historik, social, ekonomik, kulturor e psikologjik. Për shembull, problemi korrupsionit në institucionet qeveritare kërkon shqyrtimin paraprak të shërbimit civil dhe kërkesat etike e ligjore për punonjësit e këtij shërbimi. Po kështu, problemi i nepotizmit nuk mund të trajtohet jashtë kontekstit kulturor e psikologjik, kur dihet që kultura të caktuara e konsiderojnë atë detyrim moral.

Kjo kërkon që kurrikulat e lëndëve shoqërore, veçanërisht hapësirat që ekzistojnë në kuadrin e kurrikulës në bazë shkolle, të pasurohen me konceptet dhe njohuritë e domosdoshme për edukimin kundër korrupsionit, në të gjitha aspektet e tij.

Një aspekt i rëndësishëm i edukimit kundër korrupsionit është sigurimi i informacionit të nevojshëm për analiza, për shqyrtim kritik e për marrje vendimesh në fushën e qëndrimeve kundër korrupsionit në shkollë e në jetë. Një pjesë e rëndësishme është njohja e legjislacionit shqiptar për çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin, me llojet e format e tij në fusha të ndryshme të veprimarisë shoqërore. Po aq e rëndësishme është edhe njohja me masat e parashikuara nga shteti (strategji e vendime konkrete) të cilat dëshmojnë edhe gatishmërinë e shoqërisë për të luftuar korrupsionin si dhe mbështetjen që qytetari gjen në këtë luftë. Kjo do të thotë që shkolla duhet të jetë vazhdimisht e përditësuar me këtë lloj informacioni dhe sigurimi i tij duhet të jetë një objektivi i përhershëm i gjithë komunitetit shkollor.

3. DISA STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES NË KUADËR TË EDUKIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT²

3.1 Shtjellim idesh

Kjo metodë ndërvepruese mjaft e njohur dhe e përdorur gjerësisht në mjediset arsimore synon të nxisë pjesëmarrësit të përdorin imagjinatën dhe të jenë krijues në gjetjen e zgjidhjeve të duhura për një problem të caktuar nëpërmjet kontributit të anëtarëve të grupit.

Cilat janë disa nga rregullat që duhen mbajtur parasysh kur zhvillojmë një metodë të tillë?

- Gjatë zhvillimit të veprimtarisë nuk lejohet të bëhet vlerësimi i ideve të shprehura, pasi nëse nxënësit gjykojnë dhe vlerësojnë idetë e shprehura, vëmendja do të përqendrohej më shumë në mbrojtjen e ideve se sa në dhënien e ideve të reja, të cilat janë synimi parësor i kësaj faze të veprimtarisë.
- Të gjithë nxënësit duhen nxitur të japin sa më shumë ide, madje duhen nxitur edhe ide “të guximshme”. Kjo ka vlerë pasi prirja e nxënësve është të censurojnë idetë e tyre duke pasur frikë nga mendimi se mund të japin ide që tingëllojnë të paarsyeshme.
- Kjo metodë kërkon dhënien e sa më shumë ideve, pasi në fund të fundit sasia do të çojë edhe në arritjen e cilësisë. Madje shpejtësia me të cilën jepen idetë shmang edhe vlerësimin e tyre dhe për rrjedhojë rrit edhe numrin e ideve të shprehura.
- Secili është i lirë të ndryshojë idetë e tij të shprehura më parë ose ato të tjerëve. Kombinimi ose ndryshimi i ideve çon në ide të reja, ndoshta më “cilësore” se të parat.

Realizimi

- Nxënësit ulen lirisht sipas dëshirës.
- Është e domosdoshme që në klasë të ketë një tabelë ose një tabak të madh letre për të shkruar idetë e shprehura.
- Bëhet i njohur problemi ose çështja që do të trajtohet.
- Bëhen të njohura rregullat:
 - Nuk lejohet vlerësimi;
 - Nxiten idetë personale të nxënësve;
 - Sa më shumë ide, aq më mirë është;
 - Mbështetja tek idetë e të tjerëve ose kombinimi i ideve të shprehura më parë.
- Idetë regjistrohen në tabelë ose në tabakun e letrës sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Mësuesi mund të shtojë idetë e tij si çdo pjesëmarrës tjetër.
- Të mos lejohen talljet, komentet, etj.

² Shih “Edukimi ligjor në shkollë”, manual për mësuesit e shkollave të mesme, Tiranë 2003, me autor Astrit Dautaj dhe Adnor Shameti, botim i Fondacionit “Klinika e Ligjit”

- Në fund, diskutohen dhe vlerësohen idetë e shprehura.

3.2 Njëri mëson tjetrin

Kjo strategji përdoret për të rritur interesimin e nxënësve gjatë paraqitjes së një mësimi ose kreu të ri si edhe gjatë fazës së përfundimit të tij. Kjo ndihmon dhe aftëson nxënësit të ndajnë informacionin me njëri-tjetrin.

Realizimi

1. Mësuesi përgatit paraprakisht fletët në të cilat përmbahen fakte rreth mësimit (një fakt, një fletë) të cilat i shpërndahen nxënësve (një nxënës, një fletë).
2. Çdo nxënës duhet të lexojë për disa minuta informacionin që ndodhet në fletën e tij, ndërkohë që mësuesi përpiqet të ndihmojë nxënësit që kanë nevojë për të kuptuar më mirë informacionin e fletës së tyre.
3. Mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të lëvizin nëpër klasë për të transmetuar informacionin që ndodhet në fletën e tyre nxënësve të tjerë. Kjo duhet të vazhdojë deri sa të gjithë nxënësit të jenë informuar për informacionin që ndodhet në të gjitha fletët.
4. Gjatë këtij procesi të shkëmbimit të informacionit, nxënësit duhet të flasë me nxënësin pasardhës vetëm pasi të ketë mbaruar shkëmbimin e informacionit me atë paraardhës. Pra, nxënësi nuk lejohet të flasë njëkohësisht me disa nxënës.
5. Pasi nxënësit të kenë mbaruar veprimtarinë, mësuesi i pyet ata për atë që mësuan nga shkëmbimi i informacionit ndërmjet tyre.

3.3 Të pyeturit

Rëndësia e kësaj teknike për suksesin e mësimit është e madhe. Pyetjet duhet të jenë të tilla që të kërkojnë vënie në punë të arsyeshme dhe të niveleve të larta të menduarit, si dhe të nxisin dialogun ndërmjet nxënësve. Nxënësit duhet të nxiten të shqyrtojnë alternativa të ndryshme zgjidhjeje për problemet e tyre mësimore, reale apo imagjinare qofshin ato.

Megjithëse disa nga pyetjet mund t'i shërbejnë vjeljes së informacionit për njohuritë e nxënësve, qëllimi kryesor i tyre duhet të jetë aftësimi i nxënësve për të zgjidhur probleme. Në këtë mënyrë sistemi i pyetjeve që duhet të zhvillohen në klasë duhet të përfshijë nxënësit në proceset e analizës dhe të sintezës së koncepteve kryesore dhe më pas t'i udhëheqë ata në zbatimin e njohurive në praktikë.

Realizimi

- Nxënësve nuk u kërkohet vetëm të riprodhojnë informacionin, por ftohen ta përdorin atë, duke iu ofruar situata problemore, imagjinare ose reale, për zgjidhje.
- Nxënësve u kërkohet të formulojnë gjykime rreth ligjeve ose politikave publike. Në çdo rast, atyre u kërkohen argumente për të mbështetur gjykimet e dhëna.

- Në raste konfliktesh, nxënësve u kërkohet të ofrojnë alternativa zgjidhjeje duke dhënë argumentet për zgjidhjet më të mira.

3.4 Loja me role

Gjatë lojës me role nxënësit ndjejnë, mendojnë ose veprojnë si çdo individ tjetër në varësi të problemit ose të situatës.

Loja me role është një metodë që synon:

- të zhvillojë imagjinatën dhe shprehitë e të menduarit kritik;
- të nxisë shprehjen e qëndrimeve, të opinioneve dhe të vlerave;
- të zhvillojë më tej aftësinë e nxënësve për të zhvilluar dhe vlerësuar alternativa të ndryshme veprimi;
- të zhvillojë ndjenjën e të kuptuarit të ndjenjave të tjetrit.

Realizimi

- Veprimtaritë fillestare duhet të jenë të thjeshta. Shkalla e vështirësisë së tyre duhet të vijë gradualisht në rritje, në përputhje me vetë synimet e lojës me role.
- Nga nxënësit nuk duhet pritur përsosmëria e lojës me role që në fillim. Atyre u duhet dhënë koha e mjaftueshme për të fituar aftësitë që kërkon loja me role.
- Gjatë përdorimit të roleve është mirë që mësuesi t'u ofrojë nxënësve larmi veprimtarish.
- Gjatë zhvillimit të lojës me role, mësuesi duhet të mbajë mirë parasysh fazat e mëposhtme:
 - planifikimi paraprak dhe parapërgatitja e mësuesit;
 - parapërgatitja dhe trajnimi i nxënësve;
 - përfshirja aktive e klasës në të gjithë veprimtarinë;
 - diskutime të kujdesshme dhe reflektim rreth veprimtarisë.
- Nëse nxënësit ndjehen të shqetësuar për rolet që kanë, është mirë që ato të zhvillohen në mjedise më të sigurta, në të cilat ekziston klimë mirëkuptimi për të gjithë. Kjo do t'u japë mundësi atyre të kuptojnë se mund të ekzistojnë disa mënyra për të reaguar ndaj një situatë ose problemi. Kjo gjë arrihet nëpërmjet ushtrimeve të herëpashershme të nxënësve në veprimtari të tilla.
- Përmbledhja duhet të shoqërohet me analiza dhe reflektime të thella të nxënësve dhe të mësuesve.

3.5 Përdorimi i materialeve audio dhe video

Zhvillimi i mësimave të edukimit kundër korrupsionit do të pasurohet nëse në të do të mund të përdoren materiale të ndryshme audio dhe video.

Këto materiale transmetojnë, në një kohë të shkurtër, informacione të caktuara, gjë që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë shprehitë e tyre vëzhguese dhe analitike. Përveç

kësaj, ata i ndihmojnë nxënësit të formulojnë, të shprehin dhe të qartësojnë opinionet e tyre, duke rritur motivimin dhe interesin në fushën e tyre të studimit.

Realizimi

- a) Zgjidhet një mjet audio dhe video që ka lidhje me temën që do të zhvillohet.
- b) Ai rishikohet me kujdes përpara se t'i bëhet i njohur nxënësve. Kjo ka rëndësi për të përcaktuar kohën dhe mënyrën më të mirë për përdorimin e tij në klasë, në përputhje me planin e orës së mësimin dhe në harmoni me teknika të tjera të parashikuara në të. Përveç kësaj, materiali duhet parë paraprakisht edhe për të kontrolluar nëse ai është i pastër nga njëanshmëritë dhe paragjykimet.
- c) Paraqitja e materialit audio dhe video nuk duhet të bëhet jashtë përmbajtjes së kreut ose të lëndës, ose i palidhur me materiale të tjera. Qëllimi i tij është që të aftësohen nxënësit të zbulojnë thelbin e dukurisë në trajtim dhe lidhjen e saj me problemet e tjera të lëndës.
- d) Paraqitja e materialit mund të bëhet e plotë ose pjesë-pjesë duke i lënë nxënësit mundësinë e reflektimit dhe të diskutimeve të mëtejshme.
- e) Përmbledhja e materialit. Mësuesi duhet të jetë kurdoherë i përgatitur të bëjë përmbledhjen e materialit të paraqitur dhe nxënësve u duhet dhënë në çdo rast mundësia të diskutojnë për atë që shohin dhe dëgjojnë. Ata kanë të drejtë ta diskutojnë materialin e paraqitur dhe duhen nxitur të shprehin opinionet dhe komentet e tyre për të. Përveç kësaj, mësuesi mund t'u kërkojë atyre të identifikojnë njëanshmëritë ose mungesat e tjera të informacionit audio dhe video me të cilin ata u njohën si dhe të shprehin mendimin e tyre, jo vetëm lidhur me materialin e paraqitur, por dhe me dukurinë që ai përfaqëson ose shpreh.

3.6 Burimet në komunitet (bashkësi)

Në çdo komunitet ka shumë burime njerëzore që mund të pasurojnë procesin e mësimdhënies. Përdorimi i tyre mund të bëhet në dy mënyra:

- me pjesëmarrjen në orën e mësimin të personave të ftuar; ose,
- e tërë klasa ftohet të marrë pjesë në një veprimtari të komunitetit.

Qëllimi i përdorimit të personave të ftuar ose vizitat në vende të posaçme të komunitetit mund t'iu sigurojë nxënësve informacione të larmishme lidhur me çështjen në trajtim, si dhe përvoja që nuk mund të përfshihen në një tekst shkollor. Të nxënët përmes burimeve në komunitet përbën një ndër veçoritë e edukimit ligjor, pasi u jep mundësi nxënësve të njihen sado pak me sistemin ligjor në veprim. Përdorimi i personave të ftuar nga shoqata të specializuara avokatësh apo juristësh mund t'u japë nxënësve mundësi që të përfshihen, në një farë mënyre, në fushën e ligjit, të zgjerojnë këndvështrimet e tyre për të dhe, si i tillë, i shërben realizimit të objektivave të edukimit ligjor në përgjithësi.

Realizimi

- Në fillim zgjidhet personi që do të ftohet. Numri i personave që mund të ftohen mund të jetë i madh dhe kjo varet nga tema e mësimit dhe qëllimet e saj. Ata mund të jenë juristë, avokatë, studentë të fakultetit të drejtësisë, punonjës të policisë etj. Por ata mund të jenë edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, punonjës socialë, gazetarë etj.
- Për të përfituar sa më shumë nga i ftuari, është e domosdoshme përgatitja paraprake e folësit dhe e klasës. I ftuari duhet të ketë informacionin e nevojshëm për klasën, për temën që do të trajtohet dhe interesin e nxënësve për të. Në të njëjtën kohë, ai duhet të njihet me objektivat e lëndës në përgjithësi dhe të temës në veçanti dhe të përgatisë fjalën e tij në përputhje me to. Po kështu, edhe klasa duhet të njihet me personin që do të ftohet dhe duhet të përgatisë edhe një listë pyetjesh për të, mundësisht të shkruara, me të cilat i ftuari duhet të njihet paraprakisht.
- Zakonisht të ftuarit paraqesin një material të shkurtër lidhur me çështjen për të cilën janë ftuar dhe për të cilën kanë përvojë dhe më pas vijnë me një seancë pyetje-përgjigjesh.
- Përveç kësaj, i ftuari mund të përfshihet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në një veprimtari të planifikuar në klasë, për shembull, ai mund të luajë rolin e një gjyqtari ose të një dëshmitari në një gjyq të imituar në klasë, ai mund të ftohet në një diskutim në klasë, ose të luajë rolin e një ligjberësi që u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve në një konferencë shtypi të improvizuar në klasë. Përfshirja e të ftuarit në veprimtarinë e klasës e liron këtë të fundit nga përgjegjësia e administrimit të saj dhe suksesi i veprimtarisë së planifikuar të klasës nuk varet vetëm nga aftësitë e të ftuarit në të. Së fundi, nëse i ftuari nuk është në gjendje të vijë në klasë, veprimtaria e saj nuk dështon.
- Përmbledhja. Pas zhvillimit të orës së mësimit ose si pjesë e saj, mësuesi duhet të pyesë klasën për atë çka ata mësuan nga i ftuari, si u ndjenë, ç'refleksione kanë, etj.

3.7 Të menduarit kritik dhe trajtimi i çështjeve kontradiktore

Një nga arsyt kryesore të studimit të çështjeve kontradiktore është nxitja e zhvillimit të shprehive të të dëgjuarit dhe të komunikimit, rritja e ndjeshmërisë (domethënë e aftësisë dhe e dëshirës së nxënësit për të vënë veten në vendin e tjetrit, me qëllim që të kuptojë më mirë ndjenjat dhe gjendjen e tij emocionale, shpirtërore ose intelektuale), rritja e aftësisë për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime, për të zhvilluar shprehitë për të arsyetuar dhe menduar në mënyrë kritike si dhe për të rritur aftësitë e nxënësve për të pasur, për të mbështetur dhe për të përdorur bindjet e tyre.

Realizimi

Metodat dhe teknikat që mund të përdoren për të rritur aftësinë e nxënësit për të menduar në mënyrë kritike për çështjet kontradiktore janë të shumta. Ato më të përdorurat janë: *radhitja e opinioneve në segmentin e vazhdimësisë së vlerave*. (segmenti me dy skaje i lejon nxënësit të pozicionohen e të ripozicionohen në vazhdimësi, sa në njërin skaj të tjetrit), *deklaratat e hapura dhe veprimtaritë që*

kërkojnë renditjen sipas një kriteri të caktuar. Pavarësisht nga teknika, procesi i të menduarit në mënyrë kritike për çështjet kontradiktore përfshin hapat e mëposhtëm:

- (1) Nxënësve u kërkohet ose iu jepet mundësia për të shprehur qëndrimin e tyre për një çështje të caktuar.
- (2) Nxënësve u kërkohet të qartësojnë mendimin e shprehur. Kjo mund të bëhet duket zhvilluar pyetje të tilla si:
 - ✓ Çfarë doni të thoni me... ?
 - ✓ A mund të shpjegoni qëndrimin tuaj?
 - ✓ A mund të jepni një përcaktim për mendimin që shprehët? Etj.
- (3) Nxënësit duhet të shqyrtojnë arsyet që mbështesin mendimin e tyre. Për këtë, mund të ndihmojnë pyetje të tilla si:
 - ✓ Pse mendoni kështu?
 - ✓ Cilat janë arsyet që mbështesin mendimin tuaj?
 - ✓ Cilat janë argumentet që jepni për të mbështetur qëndrimin tuaj?
 - ✓ Cilat janë faktet që mbështesin pikëpamjen tuaj? Etj.
- (4) Nxënësve u kërkohet që të marrin parasysh pikëpamjet e kundërta. Kjo ka shumë rëndësi dhe mund të realizohet me anë të pyetjeve të tilla si:
 - ✓ Si mendoni se ndjehen të tjerët për ...?
 - ✓ Cilat janë disa nga mendimet e të tjerëve për...?
 - ✓ Cilat janë alternativat që ekzistojnë përveç qëndrimit tuaj? Etj.
- (5) Nxënësit duhet të analizojnë qëndrimin e tyre dhe këndvështrimet e të tjerëve. Kjo do të thotë që nxënësit duhet të krahasojnë dhe të kundërvënë pikëpamjet dhe pasojat e secilës prej tyre. Pyetjet tipike që përdoren për të përfshirë nxënësit në një proces të tillë janë:
 - ✓ Cili është argumenti kryesor që mbështet pikëpamjen tuaj? Cila është pika e dobët e pikëpamjes suaj?
 - ✓ Cili është argumenti më i fortë që kundërshton pikëpamjen tuaj? Po pika më e dobët e pikëpamjes së kundërt me ju?
 - ✓ Cilat janë faktet që kundërshtojnë ose mbështesin pikëpamjen tuaj?
- (6) Të menduarit për pasojat logjike që mund të shoqërojnë çdo pikëpamje të shprehur mund të arrihet me anë të pyetjeve të tilla si:
 - ✓ Çfarë mund të ndodhë nëse pikëpamja juaj pranohet nga shoqëria?
 - ✓ Cilat mund të jenë disa nga pasojat e saj për shoqërinë?
 - ✓ Cili mund të jetë rezultati përfundimtar i saj?
- (7) Nxënësit duhet të marrin një vendim lidhur me çështjen në diskutim. Ky është edhe hapi i fundit në këtë proces. Kjo mund të arrihet duke i ftuar nxënësit të rivlerësojnë dhe të zgjidhin konfliktin ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme. Disa nga pyetjet që mund të bëhen në këtë rast janë:
 - ✓ Cili mund të ishte rezultati më i mirë?
 - ✓ Cili është rezultati më i dëshiruar?
 - ✓ Si mund ta arrijmë atë?
 - ✓ Ç' duhet bërë për të arritur qëllimin e dëshiruar? Etj.

Metodat që nxisin të menduarit kritik për çështjet kontradiktore

a) Radhitja e opinioneve

Kjo është një metodë që u lejon nxënësve të shprehin mendimin e tyre për çështjen në studim. Përgjithësisht, radhitja lejon një shpërndarje të opinioneve (për shembull, nga: *jam plotësisht dakord /jam dakord/ jam i pavendosur/ nuk jam dakord/ nuk jam absolutisht dakord*).

Një radhitje e tillë e opinioneve mund:

- të shërbejë si nxitje për diskutime në klasë;
- t'i japë mësuesit informacion për t'u njohur me vlerat, qëndrimet dhe bindjet e nxënësve;
- të përdoret për të vlerësuar ndryshimet e mundshme në qëndrimet e nxënësve si rrjedhojë e procesit të të mësuarit.

Për të realizuar këtë metodë, mësuesi duhet të sigurojë që çdo nxënës të mund të shprehë lirisht mendimin e tij personal.

Në fund, nxënësve duhet t'u kërkohet të argumentojnë mendimet e tyre dhe, në të njëjtën kohë, ata duhet të mësojnë të dëgjojnë edhe mendimet e kundërta.


Është mirë që mësuesi, duke e përdorur këtë metodë për çështje të ndryshme, të kontrollojë se sa qëndrueshmëri kanë nxënësit në pikëpamjet e shprehura.

Po kështu, mësuesi mund t'u ofrojë nxënësve edhe ndonjë studim rasti që lidhet me ndonjë mendim të veçantë të shprehur nga nxënësit gjatë radhitjes së opinioneve. Për shembull, nëse pjesa më e madhe e nxënësve shprehin pro ose kundër dënimit të një akti korrupsioni, mësuesi mund t'u japë atyre një studim rasti që kërkon një analizë më të thellë nga ana e tyre të një çështjeje të caktuar që lidhet me këtë korrupsion.

b) Renditja sipas një kriteri të caktuar. Vazhdimësia e vlerave

Renditja sipas një kriteri të caktuar është një metodë që u ofron nxënësve mundësinë të analizojnë dhe të diskutojnë idetë ose bindjet e tyre, duke u kërkuar të bëjnë zgjedhjet ndërmjet disa alternativave që konkurojnë me njëra-tjetrën. Kjo metodë mund të përdoret, për shembull, kur nxënësve u kërkohet të renditin akte korrupsioni sipas shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të tyre.

Një variant i kësaj strategjie është vazhdimësia e vlerave, që u kërkon nxënësve të vendosin veten midis dy skajeve (A, B) të një segmenti, të cilat përfaqësojnë pikëpamje diametralisht të kundërta lidhur me një çështje të caktuar: për shembull: jam krejtësisht kundër dënimit të këtij akti korrupsioni – jam plotësisht dakord për dënimin e këtij akti).



Është mirë që nxënësve t'u jepet mundësia të argumentojnë vendosjen e tyre në një segment vlerash të kundërta ose të ndryshme, të dëgjojnë pikëpamjet e kundërta të të tjerëve dhe të rivlerësojnë qëndrimet e tyre pas diskutimeve ose reflektimeve të bëra.

3.8 Studimi i rastit

Studimi i rastit është një metodë e orientuar nga shqyrtimi (hetimi) i thelluar i çështjes, për shembull, i një rasti korrupsioni. Ai synon të ndihmojë nxënësit në zbatimin e njohurive (përfshirë ato ligjore) në situata të ndryshme jetësore. Përveç njohjes me një rezultat ligjor që lidhet me një problem të caktuar (korrupsioni), nxënësit vihen në situata në të cilat ata duhet të zbulojnë dhe të shqyrtojnë si idetë ashtu dhe përfundimet e tyre. Një proces i tillë rrit aftësitë e nxënësve për të bërë analiza e gjykime të pavarura, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të marrë vendime. Në fushën afektive, ai rrit interesin e tyre në shqyrtimin e ideve dhe të përfundimeve që lidhen me to.

Si i tillë, studimi i rastit kërkon nga nxënësit:

- të analizojnë situata problemore;
- të sintetizojnë dhe të arrijnë në përfundime;
- të gjykojnë dhe të vlerësojnë përfundimet e nxjerra;
- të zbatojnë njohuritë në situata reale.

Realizimi

1. Kuptimi i fakteve në studimin e rastit

Fillimisht, nxënësit duhet të kuptojnë faktet e studimit të rastit. Ata duhet të lexojnë ose të dëgjojnë me kujdes përshkrimet e tyre. Një mënyrë e efektshme për të siguruar të kuptuarit e fakteve të studimit të rastit nga nxënësit, është që ata të vendosen në çift, ku secili prej tyre përpiqet që t'i përmbledhë faktet e tij për t'ia thënë tjetrit.

Për të ndihmuar nxënësit në kuptimin e studimit të rastit, ata ftohen në dialogë me pyetje të tilla si:

- Çfarë ndodh në këtë rast?
- Cilat janë palët e përfshira në të?
- Cilat janë motivet e veprimeve të përfshira në rast?
- Cilat fakte janë të rëndësishëm?
- Çfarë mungon?

Është e rëndësishme që mësuesi të verifikojë nëse nxënësit i kanë kuptuar si duhet faktet e studimit të rastit.

2. Përcaktimi i problemit (i çështjes)

Përcaktimi i problemit dhe i aspekteve që lidhen me të ka shumë rëndësi për vazhdimësinë e veprimtarisë. Mund të ndodhë që për nxënësit të jetë e vështirë të përcaktojnë ose të paraqesin, në formën e një pyetjeje, çështjen ligjore që qëndron në thelb të një studimi rasti. Në këtë rast, mësuesi i ndihmon ata dhe i fton që, përveç aspektit ligjor të një studimi rasti, të zbulojnë edhe aspekte të tjera politike, morale ose praktike që përfshihen në të. Për shembull, në një rast të një pacienti të moshuar, i cili vuan nga një sëmundje e pashërueshme, pjesëtarët e familjes së tij i kërkojnë mjekut që ndjek kurën, përkundrejt një ryshfeti, t'i japë fund jetës së të afërmit të tyre. Mjeku ndodhet në dilemë etike. Në këtë rast, mund të trajtohen aspektet e mëposhtme:

- **Ligjore:** Cila është çështja ligjore? (dalohet fakti nga çështja ligjore)
- **Politike:** Cili duhet të jetë ligji? (A duhet që të lejohet me ligj kjo gjë?)
- **Etike:** Cila është dilema etike? Cilat vlera morale janë më të rëndësishme? Pse?
- **Praktike:** Si mund të zgjidhim praktikisht situatën ligjore në të cilën ndodhemi? Cilat janë mundësitë e zgjidhjes? Etj.

3. Diskutimi i argumenteve

Pasi nxënësit të jenë njohur me faktet dhe me çështjet që përfshihen në një studim rasti, ata duhet të zhvillojnë dhe të diskutojnë argumentet në favor të një qëndrimi të caktuar ose kundër tij. Kur diskutohen argumentet, duhet mbajtur parasysh që nxënësi:

- të përcaktojë argumentet ligjore, politike, morale etj, duke konsideruar të dy anët e problemit;
- të dallojë argumentet më të rëndësishme dhe më bindëse nga ato që nuk janë të tilla;
- të marrë parasysh pasojat e shumëfishta të çdo zgjedhjeje që do të bëjë;
- të marrë parasysh alternativa të ndryshme.

Është i domosdoshëm krijimi i një klime të hapur dhe të ngrohtë gjatë diskutimit, që lejon dhe mirëpret të gjitha pikëpamjet dhe idetë, sado të ndryshme dhe kundërshtuese të jenë ato. Për të krijuar një klimë të tillë, nxënësit duhen nxitur të dëgjojnë, të marrin parasysh dhe të vlerësojnë të gjitha këndvështrimet e shprehura.

4. Marrja e vendimit

Marrja e vendimit është edhe përgjigjja ose zgjidhja e studimit të rastit. Zakonisht, nxënësit nxiten ta japin vetë vendimin. Në çdo rast, ata duhet të diskutojnë, të krahasojnë alternativat e ndryshme të zgjidhjes dhe të japin kurdoherë shpjegimet përkatëse.

Kur nxënësve u jepet vendimi nga mësuesi, atyre u kërkohet ta vlerësojnë atë, duke marrë parasysh edhe pasojat e tij për shoqërinë, për individët e përfshirë në studimin e rastit, etj.

5. Variante

Kur mësuesi u jep nxënësve studimet e rastit, ai mund të zgjedhë një ndër variantet e mëposhtme:

1. Studimi i rastit është dhënë i plotë: faktet, problemi (çështja), argumentet, vendimi. Nxënësit i kërkohet:

- të identifikojë elementet e tij;
- të vlerësojë vendimin.

2. Janë dhënë faktet dhe problemi. Nxënësit i kërkohet të identifikojë argumentet e kundërta.

3. Janë dhënë faktet, problemi, argumentet dhe opinione të ndryshme lidhur me zgjidhjen. Nxënësit i kërkohet:

- të zgjedhë opinionin me të cilin është dakord, duke dhënë dhe shpjegimet përkatëse;
- të krahasojë zgjedhjen e tij me vendimin që i bëhet i njohur më pas.

4. Janë dhënë faktet, problemi, argumentet. Nxënësi duhet të marrë vendim mbi bazën e arsytimit.

Sugjerime për zgjedhjen e studimeve të rasteve

Për zgjedhjen e studimeve të rastit, të vlefshme për t'u zhvilluar në një veprimtari në fushën e edukimit kundër korrupsionit, është e rëndësishme të mbahen parasysh kriteret e mëposhtme:

1. Njohuritë juridike

Këtu përfshihen ato studime rasti, njohja e të cilave shërben për zhvillimin e njohurive bazë të domosdoshme për të kuptuar ligjin dhe për të qenë të aftë për të marrë vendime të pjekura e logjike rreth çështjeve të politikës së sotme publike, për shembull, kundër korrupsionit. Ky kriter nënkupton që nxënësi nuk duhet vetëm të mësojë se si të trajtojë një ose disa studime rasti, por edhe të vlerësojë që disa prej tyre janë aq të rëndësishëm, sa që është e domosdoshme të njihen konkretisht.

2. Çështjet e “nxeha” të politikës publike

Quhen të tilla çështjet që janë ose që, shpejt a vonë, do të jenë objekt i diskutimit publik dhe politik, pavarësisht se cili ka qenë ose do të jetë vendimi, për shembull, i gjykatave lidhur me to. Këto janë çështje për të cilat ekziston një interes i gjerë apo i theksuar publik, përfshirje të aktorëve të ndryshëm të rëndësishëm në shoqëri si dhe e autoriteteve dhe institucioneve publike.

3. Faktet interesante

Këtu futen çështjet të cilat përputhen me interesat e brezit të ri. Disa nga këto mund të marrin jetë nga të rinjtë ose në emër të tyre. Ndër to, mund të jenë çështjet që lidhen me shkollën. Duhet të bëjmë kujdes pasi, kur flasim për përputhje me interesat e të

rinjve ose kur cilësojmë një fakt ose një çështje si interesante, hamendësohet që të gjithë të rinjtë janë të interesuar njëllor rreth tij/saj, në një kohë kur, të gjithë e dimë se kjo nuk është e vërtetë. Për të shmangur këtë, është e domosdoshme që të njihen mirë veçoritë, interesat dhe preferencat e nxënësve.

4. Çështje të përhershme ose kundërshtuese

Një çështje ligjore ose kushtetuese që përmbahet në një rast përsëritet në një mënyrë ose në një tjetër, sepse ajo përfaqëson një konflikt ose tension ndërmjet vlerave demokratike pozitive si, mundësitë e barabarta, drejtësia, interesi i përbashkët etj. Është mirë që nxënësit të mësojnë rreth rasteve të tilla sepse ata nxitin jo vetëm të nxënit, por edhe përsosjen morale. Përveç kësaj, edhe pse vetë rasti ose çështja humbasin parësinë e tyre në kohë dhe hapësirë ose ndryshojnë, konflikti ndërmjet vlerave që ata përfaqësojnë do të rishfaqet herë pas here. Në qoftë se pas një pyetje të tillë si: “Me se ka të bëjë ky rast”? (dhe me këtë kihet parasysh një rast konkret çfarëdo) nxënësit do të vijnë te konflikti në fjalë, atëherë mund të themi se kriteri për të cilin po flasim është plotësuar.

5. Fakte “të kapshme”(të kuptueshme)

Është e rëndësishme që faktet e një rasti të jenë të kuptueshme nga nxënësit. Vetëm në këtë rast mund të themi se rasti mund t’i vlejë qëllimit për të cilin është zgjedhur (është i efektshëm). Mund të ndodhë që rasti të plotësojë disa nga kriteret, por në të njëjtën kohë të jetë i një shkalle të tillë vështirësie, sa që zbulimi i thelbit të tij nga nxënësit do të ishte praktikisht i pamundur. Në fakt, shumë raste kanë të bëjnë me rregullime ose procedura që, ndonëse u interesojnë specialistëve, nuk mund të kuptohen lehtë nga ne. Në të kundërtën, një rast që plotëson këtë kriter mund të përmbajë fakte të thjeshtë e interesante që do të na krijonin mundësinë të shpenzonim pjesën më të madhe të kohës duke u marrë me të.

6. Lidhja ose përputhshmëria me programin mësimor

Si rregull, faktet që përmban rasti dhe çështja ose çështjet duhet të jenë në përputhje me synimet e programit mësimor.

Në këtë rast, le të kujtojmë pyetjen që ia bëjmë vetes sa herë që fillojmë një veprimtari, ose përgatisim një orë mësimi: *Çfarë do të dijë dhe do të jetë i aftë të bëjë nxënësi në fund të veprimtarisë/mësimit/ kreut/lëndës në shkollë?* Pra, nëse rasti e çon nxënësin drejt objektivit të përcaktuar, atëherë mund të thuhet se kriteri është plotësuar. Për shembull, nëse një nga objektivat tanë e programit mësimor do të ishte kuptimi nga nxënësit i ndarjes së pushteteve, atëherë edhe rastet do të kërkoheshin lidhur me këtë çështje.

7. Ekzistenca e materialeve mësimore cilësore

Pyetja që shtrohet në këtë rast është: *A ekzistojnë burime materiale rreth një rasti të caktuar që mund të shfrytëzohen pa vështirësi nga nxënësi?* Megjithëse, p.sh., interneti mund të ofrojë mjaft të tillë, përsëri ekziston çështja e kohës që duhet për

përkthimin dhe përdorimin e tyre nga nxënësit. Sigurisht, kjo nuk do të përbente problem për mjaft nxënës të rritur që zotërojnë gjuhën, por megjithatë, është fakt që edhe mësues shumë të mirë shfrytëzojnë materiale të përkthyer e përgatitura që më parë nga të tjerë.

8. Orientimi drejt së ardhmes

Nëse rasti do të jetë i orientuar drejt së ardhmes, atëherë ai do të shoqërohet me pyetje të tilla si: Në ç'mënyrë një ligj (për shembull, për korrupsionin) ndryshon, përshtatet dhe pasqyron ndryshimet dhe kërkesat e shoqërisë? Cilat janë disa nga çështjet që duken se do të përbëjnë shqetësim të veçantë kryesisht në të ardhmen? Jini vigjilentë për raste që lidhen me zhvillimet teknologjike dhe ato që kanë të bëjnë me shoqërinë gjithnjë e më shumëkultureshe në të cilën jetojmë.

9. Humanizmi

Për të plotësuar këtë kriter është e rëndësishme që të zgjidhen raste që vënë theksin në dimensionin njerëzor. Ka raste që shërbejnë mjaft mirë për të ngjallur interes rreth aventurave të jetës së dikujt, sikurse ka të tjerë që tregojnë se individët mund të bëjnë shumë për të ndryshuar shoqërinë. Çështja thelbësore në këtë rast do të ishte: *Në çfarë shkalle, rasti konkret hap një dritare për të kuptuar më mirë aspektin njerëzor?* Për shembull, rastet që kanë të bëjnë me një individ të caktuar (dhe që shpesh shfaqet si përfaqësues i të tjerëve) do të rritnin mjaft përgjegjësinë dhe detyrimin të rinjtë ndaj sfidave të shoqërisë. Megjithatë, nuk duhet harruar që në raste të tilla, në fokus të jenë njerëz dhe situata reale.

10. Raste që janë në interesin e mësuesit

Është i njohur fakti që të rinjtë, por jo vetëm ata, reagojnë ndaj pasionit me të cilin mësuesi trajton një çështje të caktuar. Përveç përpjekjes për të mësuar të tjerët rreth një rasti, rreth çështjeve që lidhen me të, të ardhmes, të shkuarës, dramës njerëzore etj., mësuesi transmeton tek ta edhe dëshirën për të mësuar. Për këtë arsye, do të ishte me vend që të zgjidhen raste që do të ndihmonin dhe lehtësonin mësuesin në punën me nxënësit.

4. VEPRIMTARI PRAKTIKE

Mësimi 1

Lënda: Qytetari

Klasa: X - XI

Tema: Mësues dhe nxënës: të distancuar apo të korrumpuar?

Objektivat:

Në fund të kësaj ore mësimore nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë konceptin e korrupsionit si fenomen shoqëror;
- të identifikojë format e korrupsionit në shkollë;
- të analizojë shkaqet e korrupsionit;
- të shprehë qëndrimin e tij për forma të ndryshme të korrupsionit në shkollë.

Mjetet: Rregullorja e shkollës, të dhëna statistikore të studimeve sociologjike, histori të jetuara, letër dhe lapustila, tabelë e zezë dhe shkumës, postera, ngjitës, fisha me detyra për orën tjetër.

Metoda: punë individuale dhe në grup, stuhi mendimesh, diskutim.

Koha: 2 x 45 min.

Puna parapërgatitore: Mësuesi ka përgatitur 4 raste studimore.

Ora e parë mësimore (45 min.)

Realizimi

1. Hapi i parë: (6-7 min.)

Mësuesi u kujton nxënësve se fjala korrupsion është një ndër fjalët që ndeshet rëndom jo vetëm në median e shkruar dhe atë elektronike, por edhe në fjalorin e jetës së përditshme të gjithësecilit.

Më pas ai u kërkon nxënësve të japin përkufizimin e tyre për korrupsionin. Në vijim, ata përfundojnë me një përkufizim të përbashkët të korrupsionit, në të cilin përfshihen të gjitha karakteristikat e tij si dukuri shoqërore. Mësuesi i shkruan në tabelë.

Më tej, ai fton nxënësit të identifikojnë sjelljet që ata i vlerësojnë si shprehje të korrupsionit në arsim dhe i rendit edhe këto në tabelë.

2. Hapi i dytë (25 min.)

Mësuesi e ndan klasën në katër grupe, të cilëve u jepet detyra të shqyrtojnë rastet e mëposhtme të korrupsionit të ndeshura në fushën e arsimit.

(1) Rasti i parë

Nxënësi D.SH. i klasës së 11-të të shkollës të mesme, deri në mesin e muajit maj (viti shkollor mbyllet në javën e dytë të qershorit), ishte pakalues në më shumë se tri lëndë. Ky fakt ishte i dokumentuar në proces-verbalin e mbledhjes së muajit maj të këshillit pedagogjik të shkollës.

Tri ditë përpara mbylljes së vitit shkollor, nxënësi D.Sh. i kërkon mësueses së filozofisë t'i vërë notë kaluese, me pretendimin se lënda e filozofisë është e vetmja lëndë në të cilën ai ka nota pakaluese. Kërkesën e nxënësit e mbështesin edhe disa kolegë të saj, me argumentin që ky nxënës, jo vetëm që është njëherë përsëritës i klasës së 11-të, por është edhe i sjellshëm, gjë që edhe mësuesja e filozofisë e pranon.

Megjithatë, mësuesja, e cila respekton rregullat dhe parimet e saj morale, nuk pranon t'i vërë nxënësit notë kaluese të pamërituar. Ky i fundit nuk i kushton rëndësi as provimit të vjeshtës dhe për këtë arsye mbetet përfundimisht në klasë.

Pyetje për reflektim:

- Si u bë e mundur që nxënësi D.SH, të marrë, vetëm në tri javë, nota kaluese në të gjitha lëndët?
- A mendoni se prapa kësaj historie qëndrojnë veprime korruptive, pra qëndrojnë korruptues dhe të korruptuar? Cilët janë ata?
- Cilat mund të jenë disa nga format dhe shkaqet e korrupsionit në rastin konkret?
- A mund të shmangen ato?
- Si duhet vlerësuar qëndrimi i mësueses së filozofisë?
- A njihni raste të ngjashme me atë të mësueses së filozofisë?
- A mendoni se sjellje të tilla duhet të bëhen sunduese në shkollë? Argumentoni përgjigjen.

(2) Rasti i dytë

Në pragun e mbylljes së vitit shkollor, dy mësues konstatojnë se njëri prej nxënësve maturantë kishte munguar në më shumë se 20% të orëve të mësimit në një numër të madh lëndësh. Për këtë arsye, sipas ligjit, ai mbetet në klasë.

Të dy mësuesit patën “oferta në rritje” nga familjarët e nxënësit që rrezikonte humbjen e vitit shkollor, por ata nuk pranuan të ndryshonin numrin e mungesave të bëra nga nxënësi.

Megjithatë, pas disa ditësh, emri i nxënësit ndodhej në listën e maturantëve që do të futeshin në provimet e pjekurisë. Një ditë, kryefamiljari kalon pranë dy mësuesve “kokëfortë” dhe pasi shprehet: “Ka ligj, por ka dhe Maliq”, hyn në drejtori, prej nga del buzgaz bashkë me drejtorin.

Dy mësuesit kontrollojnë regjistrin, ku vënë re, të habitur, justifikimet e disa mungesave dhe fshirjen me korrektor të disa të tjerave.

Ata vënë në dijeni kolektivin e mësuesve për këtë ngjarje. Drejtori u bën të ditur të gjithë mësuesve, si faktin që është ai që vendos, ashtu edhe faktin tjetër që shumë mësues të papunë presin radhën për punë jashtë dverve të shkollës.

Diskutoni:

- A mendoni se në këtë rast kemi të bëjmë me një shfaqje korrupsioni? Cila është ajo?
- Cilët janë palët e përfshira në këtë veprim korrupsioni?
- Cilët janë, sipas mendimit tuaj, motivet që i shtyjnë njerëzit në korrupsion në mjediset shkollore?
- A i justifikoni këto motive? Pse?
- Cila është sjellja e dy mësuesve, sjellje e zakonshme në raste të tilla, apo ata janë rast i veçuar?
- A duhet të mbeten të veçuara? Cila është përgjegjësia dhe mbështetja juaj në këtë rast?

(3) Rasti i tretë

Nxënësit A.Z. dhe L.K. ishin shokë të ngushtë. I ndanin gëzimet dhe hidhërimet së bashku. A.Z. këmbëngulte që shoku i tij duhet të mësonte më shumë, sepse mesatarja e notave të tij ishte shumë e ulët, por L.K. mjaftohej me faktin që, në atë kohë, mesatarja e notave nuk ishte kusht i domosdoshëm për të vazhduar studimet në shkollën e lartë.

Në fund të klasës së XII-të, MASH vendosi që konkursi për pranimet në universitet do të bazohej në mesataren e viteve të shkollës së mesme. L.K. u shqetësua për pak ditë, por më pas rifitoi qetësinë.

Në shtator L.K. shpallet fitues në një nga degët më të kërkuara, ndërsa A.Z. u pranua në një degë ku pranimet u bënë të hapura. I habitur, A.Z. pyeti shokun: “Si ka mundësi, që ti u pranove në një nga degët e parapëlqyera?” L.K. përgjigjet: “Ka mësues dhe drejtorë të pathyeshëm, por me sekretare bën mrekullira.”

Diskutoni:

- Identifikoni rastet e mundshme të korrupsionit që lidhen me këtë rast.
- Cilat janë format e shfaqjes së korrupsionit në mjediset shkollore?
- A mund të shmangen sjellje të tilla?
- Çfarë do t'i këshillonit një shoku që parapëlqen korrupsionin ose zgjidhje të lehta për jetën e tij?

(4) Rasti i katërt

Dy mësuese të një shkolle të mesme praktikonin zhvillimin e kurseve private me nxënësit e tyre. Njëra prej mësueseve nuk i diskriminonte nxënësit e klasës që nuk pranonin të merrin pjesë në kurset e saj, kurse mësuesja tjetër, favorizonte hapur nxënësit që ndiqnin kursin. Kjo shprehej si në qëndrimin e

saj ndaj tyre, ashtu edhe në vlerësimin e tyre, shpesh të pamërituar, me nota më të mira.

Diskutoni:

- A ka korrupsion në këtë ngjarje?
- Ç'formë ka ai?
- Cilat janë shkaqet?
- Si do ta formulonit ju ligjin për lejimin ose për ndalimin e zhvillimit të kurseve private me nxënësit të cilëve u jepet mësim?
- Argumentoni qëndrimin tuaj.

3. Hapi i tretë (8 min.)

Në këtë fazë, mësuesi njih nxënësit me tabelën e mëposhtme e cila përmban disa nga të dhënat e studimeve sociologjike dhe zyrtare lidhur me shkaqet dhe format e korrupsionit në shkollë ose me faktorët që nxitin korrupsionin dhe i fton ata t'i krahasojnë me gjetjet e tyre.

Motivet e korrupsionit në shkollë, të shprehura në %:

Nota	Mungesa	Kurse private	Rregjistrim jashtë rregullit	Shkaqe të tjera	Pa përgjigje
40	20	20	10	7	3

4. Hapi i katërt (5 min.)

Mësuesi fton nxënësit të reflektojnë lidhur me format dhe shkaqet e korrupsionit në shkollë. Në të njëjtën kohë, ai bën vlerësimin e punës së grupeve dhe i njih ata me detyrën e ardhshme.

5. Detyrë për orën e ardhshme:

Mësuesi ka përgatitur parapraktisht detyrat për secilin nga katër grupet:

- (1) Grupi i parë quhet grupi i gazetës. Detyra e këtij grupi është të përgatisë materiale për gazetë për temën e korrupsionit. Ata mund të jenë autorë të shkrimeve të tyre, të bëjnë montime të shkrimeve të të tjerëve, të përdorin kritika, ese, fjalëkryqe, karikatura, shprehje të njerëzve të njohur kundër korrupsionit etj.
- (2) Grupi i dytë quhet grupi i sensibilizimit. Ai ka për detyrë të përgatisë postera, fletë-thirrje, fletëpalosje që synojnë të sensibilizojnë njerëzit për problemet e korrupsionit, etj.

- (3) Grupi i tretë quhet grupi i pantomimës. Detyra e këtij grupi është të përdorë pantomimën për të transmetuar mesazhe të rëndësishme, veprime që duhen kryer, përfshirë ankimet pranë institucioneve kompetente për çështje të korrupsionit.
- (4) Grupi i katërt quhet grupi i protestës paqësore. Detyra e këtij grupi është të kryejë veprimet me mënyrat dhe mjetet e përdorshme për kryerjen e një proteste paqësore kundër korrupsionit, në bashkëpunim edhe me grupe të tjera, kryesisht me grupin e tretë.

Ora e dytë mësimore (45 min.)

Tema: Protesta jonë kundër korrupsionit.

Objektivat:

Në fund të kësaj ore mësimore, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë rrugë dhe forma të ndryshme për frenimin e korrupsionit;
- të shprehë qëndrimin e tij lidhur me luftën kundër korrupsionit;
- të tregojë gatishmëri për të luftuar kundër korrupsionit.

Mjetet:

- Dispozitat ligjore dhe aktet normarive në shkollë, Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijës;
- Postera, fisha të shkruara me shprehje të ndryshme për korrupsionin, fisha me emrat e institucioneve përkatëse ku do të ankohen nxënësit, letra, tabakë, formate, lapustila, tabela e zezë, shkumës, fletëpalosje, parulla, ngjitës, pineska me kokë.

Metoda: Punë individuale dhe në grup, lojë me role, bashkëbisedim.

Realizimi

Punë përgatitore: Krijohet një mjedis sensibilizues në klasë me anë të fishave, posterave ose tabakëve, të shkruar me përmbajtje nga legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve, dispozitat ligjore dhe aktet normative, Konventa e të Drejtave të Fëmijës. Puna e çdo grupi është pasqyruar në vende të dukshme të klasës.

1. Hapi i parë

Mësuesi kërkon që përfaqësuesit e secilit grup të paraqesin shkurt rezultatet e punës së kryer në shtëpi:

1. Grupi i gazetës paraqet materialin e përgatitur për gazetë, të cilin e vendos në vend të dukshëm në klasë.
2. Grupi i sensibilizimit paraqet posterat e përgatitur dhe i vendos ato pranë gazetës. Paraqitja e punës së dy grupeve të para ndihmon në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për lojën me role që do të realizohet nga grupi i tretë, i pantomimës.
3. Grupi i pantomimës paraqet lojën me role:
 - Paraprakisht, në klasë krijohet skena e duhur për lojën me role. Për këtë qëllim, në pjesën ballore të klasës janë vendosur tavolina, në të cilat qëndrojnë nxënësit që përfaqësojnë institucionet të cilat marrin ankime. Këta dallohen nga emërtime të tilla, si: senatori i klasës, senati i shkollës, mësuesi kujdestar, psikologu, drejtorja, trupi pedagogjik i shkollës, drejtorja (ose zyra) arsimore rajonale, qendrat këshillimore, ligjet, gjykata.
 - Në skenarin e lojës me role, njëri nga nxënësit luan rolin e viktimës së korrupsionit. Fytyra e tij duket e zemëruar, kurse trupin e ka të mbuluar

me fisha letre me ngjyra të ndryshme, të cilat përmbajnë fjalë ose shprehje që lidhen me korrupsionin dhe format e tij. Ai takohet me radhë me përfaqësuesit e institucioneve dhe komunikon me ta me anë të pantomimës. Veprimet e tij mbështeten nga grupi i protestës paqësore që ka filluar të organizohet. Pas çdo takimi, atij i hiqen një ose dy fisha me fjalë, çka nënkupton zgjidhjen e problemit të ankimit.

4. Grupi i protestës paqësore. Kur nxënësi, viktimë e korrupsionit, del nga takimet me institucionet, ai mban ende në trupin e tij shprehje për korrupsionin. Kjo do të thotë që ai nuk i ka zgjidhur të gjitha problemet e tij dhe për këtë arsye lind nevoja e veprimit të grupit të protestës. Ky grup i bashkohet viktimës së korrupsionit me thirrje dhe parulla kundër korrupsionit.

2. Hapi i dytë

Përmbledhje dhe reflektim. Mësuesi drejton nxënësit në një proces reflektimi për korrupsionin. Ai mund t'u drejtojë atyre pyetjet e mëposhtme:

- Cilët janë disa nga llojet e korrupsionit në shkollë?
- Pse lufta kundër korrupsionit është e vështirë?
- Çfarë kërkon prej nesh kjo luftë?

Shënim:

Për të zhvilluar këtë temë ose të tjera të ngjashme, mësuesi mund të shfrytëzojë orë të lira ose tema ku preket çështja e korrupsionit, si p.sh. te kreu për demokracinë.

Mësimi 2

Lënda: Qytetari

Klasa: X

Tema: Ç'ndodh kur nuk zbatohet ligji?

Objektivat:

Në fund të kësaj ore mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë mjetet ose rrugët e njohjes së ligjit nga anëtarët e shoqërisë;
- të argumentojë rëndësinë që ka njohja e ligjit përmes shembujve të marrë nga jeta e përditshme;
- të analizojë faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit;
- të identifikojë elemente të korrupsionit në rastet e moszbatimit të ligjit dhe në ato që lidhen me mungesën e ndëshkimeve ndaj tyre;
- të diskutojë për pasojat e indiferentizmit tonë ndaj rasteve të korrupsionit për individin dhe shoqërinë.

Mjetet: Teksti i nxënësit, informacione të tjera nga media e shkruar dhe elektronike.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (10 min.)

Mësuesi shkruan në qendër të tabelës fjalën (konceptin) “Ligji” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin koncepte të tjera që lidhen me të dhe që, në lidhjen e tyre, ndihmojnë në kuptimin e përmbajtjes së ligjit. Të tilla janë, për shembull, fjalë të tilla si *sistem rregullash, instrument, faktor ndryshimi pozitiv, pengesë, parandalim, shtrëngim, territor, kohë, zbatim, interpretim, pushtet legjislativ, parlament*, etj.

Për t’u siguruar që nxënësit të ofrojnë sa më shumë koncepte, mësuesi, herë pas here, ofron vetë shembuj kuptimplotë.

Në vijim, mësuesi kërkon nga nxënësit të tregojnë gjithashtu lidhjet që ekzistojnë ndërmjet disa prej koncepteve. Për shembull, për të treguar lidhjen që ekziston ndërmjet konceptit *ligj* dhe konceptit *parandalim*, nxënësi duhet të tregojë që ligji shërben si parandalues i veprave që ai dënon.

2. Hapi i dytë (15 min.)

Në këtë fazë, mësuesi u shpjegon nxënësve rëndësinë e zbatimit të ligjit si kusht i domosdoshëm që ai të kryejë funksionet dhe të realizojë qëllimet për të cilët është

krijuar. Më tej, ai **shpjegon** rëndësinë e njohjes së ligjit për zbatimin e përgjegjshëm të tij si dhe faktin që mosnjohja e ligjit nuk është kusht për moszbatimin e tij.

Mësuesi fton nxënësit që të ndërtojnë së bashku, sipas modelit të mësipërm, një **hartë** të re **konceptesh**, duke vënë në qendër konceptin “*moszbatimi i ligjit*”. Nxënësit duhet të identifikojnë sa më shumë koncepte që lidhen me moszbatimin e ligjit, me faktorët që ndikojnë në moszbatimin e tij si dhe me format dhe shkaqet e tij në vendin tonë.

Për këtë arsye, mësuesi shkruan në tabelë konceptet: moszbatim i ligjit, faktorë, forma të moszbatimit, shkaqe të moszbatimit dhe shkruan kontributet e nxënësve sipas lidhjes së tyre me to. Nxënësit mund të përmendin koncepte të tilla si: *mospagim taksash, vjedhje, vrasje*, etj.

Në këtë rast, mësuesi bën kujdes që në listën e koncepteve të përfshihen edhe konceptet *ryshfet, korrupsion*, etj.

3. Hapi i tretë (10 min.)

Reflektim për dukurinë e korrupsionit.

Mësuesi ndalet në dukurinë e korrupsionit. Ai thekson idenë që, shpeshherë, ne e kërkojmë korrupsionin tek të tjerët ose në organet qendrore e vendore të qeverisjes, etj. Por, ne nuk i kushtojmë rëndësi pranisë së korrupsionit në jetën tonë të përditshme, të lidhur me mjedisin ku ne jetojmë. Ky lloj qëndrimi ndihmon për të krijuar klimë negative në luftën kundër korrupsionit, madje ndihmon edhe në justifikimin e tij në shumë aspekte.

Në këtë drejtim, mësuesi përmend rastin e mospagimit të energjisë elektrike nga shumë familje ose pagimi i saj padrejtësisht në shuma minimale dhe mbështetjen që kjo dukuri gjen në shumë familje.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të zbulojnë shkaqet e qëndrimeve të tilla dhe të përmendin raste të qëndrimeve të ngjashme.

4. Hapi i katërt (5 min.)

Reflektim për rëndësinë e zbatimit të ligjit

Në fund, ai fton nxënësit të reflektojnë për pasojat që shkaktohen për shoqërinë dhe individin nga moszbatimi i ligjit në përgjithësi.

Mësimi 3

Lënda: Sociologji

Klasa : XI

Tema : Krimi i “jakave të bardha”

Objektivat :

Në fund të kësaj ore mësimore, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përmendë shembuj të krimeve të jakave të bardha;
- Të përkufizojë, sipas kuptimit sociologjik, krimin e jakave të bardha;
- Të përshkruajë pasojat e krimeve të jakave të bardha për komunitetin;
- Të propozojë, të paktën tre masa që duhet të merren për të minimizuar krimin e jakave të bardha, institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre dhe rrugët e zbatimit.

Mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, gazeta, revista, fotografi, etj.

Metodat: Punë individuale dhe në grup, lojë me role, etj.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (5 min.)

Mësuesi paraqet fotografi ose tituj artikujsh nga gazetatat në të cilat bëhet fjalë për veprime korrupsioni të “jakave të bardha” dhe i fton nxënësit të shprehin ndjenjat dhe idetë që ato shkaktojnë tek ta.

2. Hapi i dytë (10 min.)

Mësuesi u **shpjegon** nxënësve kuptimin e shprehjes “jaka të bardha” dhe llojet kryesore të krimeve që lidhen me këtë grup njerëzish që etiketohen në këtë mënyrë. Ai shpjegon pasojat tepër të rënda që ky lloj krimi sjell për shoqërinë në tërësi dhe vështirësinë që ekziston për ndëshkrimin e tij, si rrjedhojë e lidhjeve të tij me nivelet e larta të pushtetit ekonomik, politik e ligjor.

3. Hapi i tretë (25 min.)

Lojë me role. Mësuesi e ndan klasën në disa grupe dhe kërkon që secili prej tyre të përzgjedhë një rast krimi të jakave të bardha. Mbi bazën e këtij krimi, grupi duhet të ndërtojë një skenar për një lojë me role në të cilën të marrin pjesë aktorë të ndryshëm të shoqërisë. Qëllimi i lojës me role do të jetë që të tregojë :

- vështirësinë që ekziston për ndëshkimin e krimit, për arsye të ryshfeteve (korrupsionit) që autorët e këtij krimi janë në gjendje të ofrojnë;
- besimin se në shoqëri ende ekziston mundësia që ky krim të ndëshkohet;
- disa nga masat që mund të ndërmerren për të luftuar krimin e jakave të bardha.

Secili grup përcakton edhe aktorët që përfaqësojnë institucionet kryesore që lidhen në një mënyrë a në një tjetër me hetimin e krimit të jakave të bardha dhe me ndëshkimin e tij.

Në fund, grupet shfaqin lojën e tyre përpara klasës.

4. Hapi i katërt (5 min.)

Reflektim. Mësuesi fton klasën në një diskutim përmbledhës të ideve kryesore që lidhen me format, shkaqet dhe mundësinë e ndëshkimit të krimeve të jakave të bardha. Në përfundim, nxënësit sugjerojnë disa masa që mund të ndërmerren, si në plan individual ashtu edhe në plan shoqëror, për luftën kundër korrupsionit të jakave të bardha.

Mësimi 4

Lënda: Qytetari

Klasa: XI

Tema: Ligji për konsumatorin

Objektivat

Në fund të kësaj ore mësimore, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë aspektet që përfshin mbrojtja e konsumatorit;
- të analizojë ligjin për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri;
- të identifikojë raste të lidhjes së luftës për mbrojtjen e konsumatorit me luftën kundër korrupsionit;
- të argumentojë rëndësinë e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit;
- të hartojnë një projektligj për luftën kundër korrupsionit për mbrojtjen e konsumatorit.

Mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, prodhime të ndryshme të ambalazhuara.

Metoda: Punë individuale dhe në grup.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (10 min.)

Mësuesi shkruan në tabelë konceptin “*Konsumator*” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin koncepte të tjera që lidhen me këtë koncept, për shembull, shëndet, mbrojtje, ligj, afat përdorimi, etj.

Ndërkohë që mësuesi shkruan në tabelë kontributet e nxënësve, ai bën edhe sugjerimet e tij, për të siguruar që, në tablonë e përgjithshme të paraqiten koncepte të rëndësishme që do të ndihmojnë, jo vetëm të shpjegohet në mënyrë tërësore koncepti i mbrojtjes së konsumatorit, por edhe të realizohen objektivat e mësimi, veçanërisht ai që lidhet me konceptin **korrupsion**.

2. Hapi i dytë (25 min.)

Në këtë fazë, mësuesi kërkon nga nxënësit që të tregojnë lidhjen ndërmjet konceptit konsumator dhe konceptit mbrojtje. Pas kësaj, ai u shpjegon atyre aspektet kryesore të mbrojtjes së konsumatorit dhe përmbajtjen e ligjit shqiptar për mbrojtjen e tij.

Ai sqaron që të gjithë janë konsumatorë, por kur janë në pozicionin e prodhuesit dhe të shitësit, të njëjtët persona pranojnë që në treg të shiten mallra, të cilave u ka kaluar afati i përdorimit, pra të dëmshme për shëndetin.

Në vijim, mësuesi u tregon atyre prodhimet e ambalazuara të cilave u ka kaluar afati i përdorimit dhe megjithatë gjenden në treg. Ai u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Sipas mendimit tuaj, përse tregtohen prodhime të skaduara, megjithëse një gjë e tillë, jo vetëm është e dëmshme për shëndetin, por edhe dënohet nga ligji?
- Cili mund të jetë veprimi i prodhuesve (shitësve) që bën të mundur ekzistencën e prodhimeve të skaduara në treg? A është ky veprim një formë korrupsioni?
- Cilët janë institucionet përgjegjëse për të mbikëqyrur dhe për të kontrolluar tregun?
- A mendoni se ato e kryejnë punën si duhet? Pse?

3. Hapi i tretë (10 min.)

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të argumentojnë pse lufta kundër korrupsionit nuk është e lehtë.

4. Detyrë shtëpie

Mësuesi ndan klasën në 3-4 grupe dhe fton nxënësit që të përgatisin një projektligj që do të sjellë ndryshime të dukshme në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Në një orë të ardhshme të mësimit, grupet do të konkurrojnë për projektligjin më të mirë.

Mësimi 5

Lënda: Filozofi

Tema: Filozofia e Platonit për të mirën dhe të drejtën

Klasa: XII

Objektivat:

Në fund të kësaj ore mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë idetë e Platonit për të mirën, të keqen, të drejtën, padrejtësinë.
- të analizojë thënien e Platonit se “Të gjithë të këqijat për individin dhe shtetin vijnë nga regjimet e këqija dhe të korruptuara”.
- të shprehë qëndrimin e tij për vlerat ku duhet të mbështetemi për të rregulluar jetën tonë.

Mjetet mësimore: Tabela, tabakë të mëdhenj letre, lapsa.

Metoda: Punë individuale dhe në grup, diskutim etj.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (5 min.)

Mësuesi fton nxënësit të shprehin mendimin e tyre për të mirën, të keqen, drejtësinë, padrejtësinë.

2. Hapi i dytë (20 min.)

Mësuesi e ndan klasën në katër grupe. Ai u lexon shprehjen e Platonit që “të gjithë të këqijat për individin dhe shtetin vijnë nga regjimet e këqija dhe të korruptuara” dhe kërkon prej tyre të për zgjedhin një formë të caktuar korrupsioni të qeverive të sotme (jo domosdoshmërisht të qeverive në vendin tonë) dhe të analizojnë pasojat e saj për shoqërinë.

Grupet paraqesin rezultatet e punës së tyre në tabakët e letrës dhe i vendosin ato në vende të dukshme në klasë. Në vijim, përfaqësuesi i çdo grupi paraqet idetë e grupit përpara klasës.

3. Hapi i tretë (5 min.)

Mësuesi fton nxënësit, që duke u mbështetur në përfundimet e punës në grupe, të përcaktojnë karakteristikat e përbashkëta të regjimeve të këqija e të korruptuara. Mësuesi i përmbledh idetë e nxënësve në tabelën e zezë.

4. Hapi i katërt (10 min.)

Reflektim

- (1) Mësuesi kërkon nga nxënësit të shprehin vlerat njerëzore ku duhet të mbështetemi për të zhvilluar një jetë të bazuar në të mirën dhe drejtësinë.

Më tej, ata ftohen të reflektojnë për pengesat që ekzistojnë në nivel individual dhe shoqëror për të jetuar sipas këtyre vlerave dhe përgjegjësinë që ka individi dhe e gjithë shoqëria për të bërë realitet këtë jetë.

Mësimi 6

Lënda: Edukatë shoqërore

Klasa: IX

Tema: Përballimi i faktorëve pengues të demokracisë

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të renditë faktorët pengues të demokracisë;
- të renditë disa nga masat kundër faktorëve pengues;
- të shpjegojë si ndikon kufizimi i korrupsionit në demokraci.

Mjetet mësimore: teksti i nxënësit, tabela, tabakë, markera, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Metoda: Punë individuale dhe në grup.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (10 min.)

Mësuesi u kujton nxënësve që demokracia është rezultat i luftës ndërmjet faktorëve që e mbështetin atë dhe e faktorëve që e pengojnë. Në Shqipëri, demokracia është në hapat e para të saj. Për këtë arsye, faktorët që e pengojnë atë janë të shumtë. Njohja dhe pakësimi i veprimtë të tyre ka rëndësi për fatin e demokracisë.


Mësuesi i fton nxënësit të kujtojnë disa prej faktorëve mbështetës dhe pengues, të mësuar në mësimin paraardhës, dhe t'i shkruajnë ato në tabelën e mëposhtme të cilën ai e skicon në dërrasën e zezë.

Faktorët mbështetës	Faktorët pengues
<ul style="list-style-type: none">▪ Rritja ekonomike▪ Mungesa e krimit▪ Kultura politike▪ Informimi	<ul style="list-style-type: none">▪ Rënia ekonomike▪ Prania e krimit▪ Mungesa e kulturës politike▪ Mungesa e informimit

2. Hapi i dytë (20 min.)

Mësuesi kërkon nga nxënësit të lexojnë mësimin e ri dhe të identifikojnë masat që duhet të merren për kufizimin e faktove pengues të demokracisë.

Më pas, ata ndërtojnë, në tabakë të mëdhenj letre, grupime që lidhin faktorët të cilët pengojnë demokracinë me masat që duhet të merren për kufizimin e tyre, sipas modelit të mëposhtëm:



3. Hapi i tretë (15 min)

Mësuesi ndan nxënësit në tre grupe. Secili prej tyre duhet të shqyrtojë një rast korrupsioni në një fushë të veprimtarisë njerëzore, përkatësisht:

- (1) Grupi i parë: Korrupsioni në mjekësi.
- (2) Grupi i dytë: Korrupsioni në arsim.
- (3) Grupi i tretë: Korrupsioni në polici.

Nxënësit, sipas detyrës së grupit, duhet të plotësojnë tabelën sipas modelit të mëposhtëm. Detyra e tyre është të shqyrtojnë shkaqet e korrupsionit konkret dhe masat që duhet të merren për parandalimin e tij. Për shembull:

Gr	Korrupsioni	Shkaku i veprimit	Masa parandaluese
I	Ryshfet mjekut	Indiferentizmi i mjekut. Mungesa e përkushtimit, etj.	Denoncim në rast kërkim ryshfeti. Sensibilizim i opinionit publik.
II	Blerja e notës	Mosdhënia e notës edhe pse meritohet, etj.	Denoncim, paga më të larta për mësuesit. Ballafaqim me komision vlerësimi.
III	Ryshfet policit rrugor	Mospagimi i gjobës nga shkelësi i kodit rrugor, për një vlerë më të vogël, etj.	Pajisja me aparatura vëzhgimi. Kontroll i cilësisë së autoshkollave, etj.

Mësimi 7

Lënda: Veprimtari ekstrakurrikulare

Klasa: IX

Tema: Korrupsioni, shkaqet, pasojat dhe masat për parandalimin e tij.

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përkufizojë përmbajtjen e konceptit të korrupsionit;
- të analizojë shkaqet e korrupsionit dhe pasojat e tij;
- të vlerësojë masat për të parandaluar ose luftuar dukurinë e korrupsionit.

Mjetet mësimore : tabelë, tabakë të mëdhenj letre, lapsa me ngjyra, fotografi.

Metoda: punë individuale dhe në grup, lojë me role etj.

Koha: 45 min.

Realizimi

Kjo orë mësimore është përgatitur kryesisht nga nxënësit si detyrë shtëpie. Detyrat e tyre kanë qenë si më poshtë:

Detyra e parë

Të ndarë në tre grupe, ata kanë pasur detyrën e mëposhtme:

1. Grupi i parë ka pasur detyrën të përzgjedhë disa raste korrupsioni dhe të tregojë **shkaqet** e tyre.
2. Grupi i dytë ka pasur detyrën të përzgjedhë disa raste korrupsioni dhe të tregojë **pasojat** e tyre për shoqërinë.
3. Grupi i tretë ka pasur detyrën të përzgjedhë disa raste korrupsioni dhe të tregojë **masat** që duhet të ndërmerren për të parandaluar ose luftuar rastet konkrete të përzgjedhura prej tyre.

Detyra e dytë

Lojë me role. Nxënësit kanë pasur detyrën të përgatisin një lojë me role me temë “Mos ndihmoni korrupsionin”.

1. Hapi i parë (25 min.)

Në këtë hap, grupet ftohen të paraqesin rezultatet e punës së tyre me anë të përfaqësuesit të tyre.

Mësuesi përmbledh rezultatet në tabelën e zezë sipas shembullit të mëposhtëm

Shkaqet e korrupsionit	Pasojat e korrupsionit	Masat për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit
<ul style="list-style-type: none">➤ Pranimi i përfitimit të paligjshëm➤ Përfitime të ndërsjella➤ Rroga të ulëta➤ Etj.	<ul style="list-style-type: none">➤ Kërcënohet demokracia➤ Shpërdorohet buxheti i shtetit➤ Prania e cilësisë së ulët të prodhimeve që janë rrjedhojë e dukurive të korrupsionit.➤ Etj.	<ul style="list-style-type: none">➤ Kallzimi i rasteve të korrupsionit➤ Nxitja e intolerancës ndaj korrupsionit➤ Edukimi kundër korrupsionit.➤ Fushata informimi për dëmet materiale dhe morale që vijnë nga korrupsioni.

2. Hapi i dytë (20 min.)

Lojë me role

(1) Nxënësit shfaqin lojën me role të përgatitur që më parë me temë “Mos ndihmoni korrupsionin”.

Në vijim, mësuesi fton nxënësit në një proces reflektimi për dukurinë e korrupsionit, gjatë të cilit ai mund të drejtojë pyetjet e mëposhtme:

- Përse është e vështirë të identifkohet dhe të luftohet korrupsioni?
- Çfarë kërkon nga ne lufta kundër korrupsionit?
- A ndiheni të gatshëm për të luftuar korrupsionin?

Mësimi 8

Lënda: Gjeografi

Klasa: IX

Tema: Problemet mjedisore në trevat shqiptare.

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë përmbajtjen e konceptit *mjedis*;
- të përshkruajë mjedisin e trevave shqiptare;
- të dallojë faktorët që ndikojnë në mjedisin e trevave shqiptare dhe mekanizmin e këtij ndikimi;
- të ilustrojë me shembuj shkallën e ndotjes së mjedisit të trevave shqiptare.

Mjetet mësimore: tabakë të mëdhenj letre, materiale të fotokopjuara, pamje dhe fotografi të mjedisit të trevave shqiptare.

Metoda: Punë individuale dhe në grup

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (5 min.)

Mësuesi, pasi shkruan në tabelë temën e mësimi “Mjedisi në trevat shqiptare”, i fton nxënësit që, përmes një stuhie mendimesh, të shprehin për mënyrën se si ata e shohin këtë mjedis, me anët e mira dhe problemet e tij. Për shembull, nxënësit mund të shprehin vlerësimin “i bukur”, por edhe i ndotur, i pasur, por edhe i kërcënuar etj. Mësuesi shkruan në tabelë si vlerësimet ashtu edhe problemet.

Më tej, ai kërkon prej nxënësve të identifikojnë fjalën e përbashkët që qëndron prapa gjithë problemeve mjedisore – njeriu. Nëse ata nuk arrijnë te ky koncept, këtë e bën vetë mësuesi.

2. Hapi i dytë (20 min.)

Në këtë fazë, mësuesi e ndan klasën në 3-4 grupe dhe fton nxënësit të plotësojnë kolonën e parë dhe të dytë të tabelës, pra kolonën “Unë dija...” dhe “Unë dua të di...” të cilën mësuesi e skicon në tabelën e zezë. Nxënësit mbështeten në njohuritë e tyre paraprake dhe në informacionin që ndodhet në tabelën e zezë për të plotësuar detyrën.

Pasi grupet plotësojnë kolonat, ata i ndajnë përfundimet me të tjerët. Ndërkohë mësuesi plotëson kolonat në tabelë me kontributin e të gjitha grupeve, sipas modelit më poshtë:

<i>Unë dija që...</i>	<i>Unë dua të di ...</i>	<i>Unë mësova...</i>
Mjedisi është gjithçka që na rrethon. Mjedisi është i ndotur. Ajri është i ndotur. Uji është i ndotur. Prania e shumë automjeteve ka sjellë ndotjen e ajrit; etj.	Cilët janë faktorët që ndikojnë në problemet e mjedisit sot? Cilat janë zonat më të prekura nga fenomeni i ndotjes së mjedisit? Pse është e vështirë të mbrohet mjedisi?	

3. Hapi i tretë (15 min.)

Mësuesi e ndan klasën në dy grupe të mëdha.

1. Grupi i parë ka për detyrë të mbrojë me argumente qëndrimin se në Shqipëri mjedisi nuk mund të mbrohet për shkak të korrupsionit të qeverisë.
2. Grupi i dytë ka për detyrë të mbrojë me argumente qëndrimin se në Shqipëri nuk ka korrupsion të qeverisë, por ka korrupsion në institucione të tjera.

Pasi nxënësit mbrojnë me argumente qëndrimin e tyre sipas grupeve, mësuesi bën përmbledhjet e diskutimeve. Ai nënvizon idenë që korrupsioni është një problem i pranishëm në çdo fushë të veprimtarisë sonë dhe në çdo nivel. Lufta kundër tij është garanci për mbrojtjen e mjedisit dhe për shfrytëzimin e arsyeshëm e jetëgjatë të tij.

Në fund, nxënësit plotësojnë kolonën e tretë të tabelës me njohuritë e fituara në këtë veprimtari, sipas modelit të mëposhtëm:

<i>Unë dija që...</i>	<i>Unë dua të di ...</i>	<i>Unë mësova...</i>
Mjedisi është gjithçka që na rrethon. Mjedisi është i ndotur. Ajri është i ndotur. Uji është i ndotur. Prania e shumë automjeteve ka sjellë ndotjen e ajrit, etj.	Cilët janë faktorët që ndikojnë në problemet e mjedisit sot? Pse është e vështirë të mbrohet mjedisi? Ç' duhet të bëjmë për të mbrojtur mjedisin ku jetojmë? Etj.	Gazrat, pluhuri, bloza lëshohen nga uzinat, fabrikat, komplekset kimike, përdorimi i automjeteve shumë të vjetra, ujërat e derdhura nga industria, etj. Lufta për mbrojtjen e mjedisit është e vështirë edhe për shkak të korrupsionit. Lufta për mbrojtjen e mjedisit kërkon jo vetëm ligje, por edhe edukim ekologjik, pra, ndërgjegjësim të të gjithë shoqërisë për rëndësinë e mbrojtjes së tij.

Mësimi 9

Lënda: Edukatë shoqërore

Klasa: IX

Tema: Protesta dhe demonstrimet paqësore

Mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, tabelë

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ç'është protesta dhe arsyet përse njerëzit e kanë përdorur atë gjatë historisë;
- të krahasojë protestën me demonstratën;
- të identifikojë probleme të demokracisë shqiptare që mund të kërkojnë përdorimin e protestës për t'u zgjidhur;
- të shprehë qëndrimin e tij protestues për raste të ndryshme korrupsioni.

Metoda: Punë individuale dhe në grup

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (20 min.)

Mësuesi e ndan tekstin në paragrafë sipas nënçështjeve që trajton dhe përgatit paraprakisht 1-2 pyetje për secilën prej tyre.

Ai u jep nxënësve detyrën të lexojnë fillimisht paragrafin e parë të mësimi të ri dhe t'u përgjigjen pyetjeve të cilat mësuesi i shkruan në tabelë. Pasi nxënësit u përgjigjen pyetjeve, ata vazhdojnë me paragrafin e dytë e kështu me radhë deri sa të kenë përfunduar të gjithë mësimin. Në vijim, janë të përcaktuara disa nga nënçështjet dhe pyetjet përkatëse.

1. Nënçështja e parë: Protesta

Pyetjet:

- Çfarë është protesta?
- Duke shfrytëzuar mësimet e historisë, tregoni përse organizohen protestat.

Mësuesi shkruan në tabelë përkufizimin e protestës së dhënë nga nxënësit dhe i fton ata të kalojnë në nënçështjen e dytë.

2. Nënçështja e dytë: Protestat dhe demonstratat

Pyetjet:

- Ku ndryshon protesta nga demonstrata?
- Në cilat shtete është përdorur për herë të parë termi “Demonstratë”?
Pse?

3. Nënçështja e tretë: Roli i demonstratave në demokraci

Pyetjet:

- Përse janë të rëndësishme demonstratat?
- Kur janë demonstratat të suksesshme?

Në fund, mësuesi, së bashku me nxënësit, bën përmbledhjen e informacionit.

2. Hapi i dytë (10 min)

Mësuesi shkruan në tabelë:

“Unë protestoj për...” dhe fton nxënësit të plotësojnë fjalinë.

Për shembull, nxënësi mund të plotësojë:

“Unë protestoj për ndotjen e madhe të mjedisit në lagjen ku jetoj”.

Mësuesi shkruan në tabelë disa nga fjalitë e plotësuara nga nxënësit.

3. Hapi i tretë (15 min.)

Protesta ime. Ese.

Mësuesi shkruan në tabelë fjalinë :

“Unë protestoj kundër korrupsionit të”

Nxënësit duhet të shkruajnë një ese të shkurtër, në të cilën të shprehin qëndrimin e tyre për një rast të caktuar korrupsioni të përzgjedhur prej tyre.

Ata që e mbarojnë më shpejt esenë, e ndajnë atë me të tjerët. Ata që nuk kanë përfunduar mund t’a vazhdojnë atë si detyrë shtëpie.

Mësuesi përzgjedh njërën prej esëve për të diskutuar për problemin e korrupsionit në shkollë ose në bashkësinë ku jetojmë.

Mësimi 10

Lënda: Edukatë shoqërore

Klasa: VIII

Tema : Ne ndryshojmë

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë ndryshimin që pëson individi në vite;
- të identifikojë dhe të vlerësojë cilësitë dhe vlerat vetjake në shërbim të qytetarisë;
- të lidhë cilësitë e tij vetjake me luftën kundër korrupsionit.

Mjetet mësimore : Teksti i nxënësit, album me fotografi familjare, fotografi të qytetit në vite të ndryshme, fletore klase.

Metoda: punë individuale dhe në grup, stuhi mendimesh, etj.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (5 min.)

Mësuesi paraqet dy fotografi: njëra tregon pamjen e një familjeje para disa viteve, ndërsa tjetra tregon një pamje të një familjeje sot.

Mësuesi fton nxënësit që, përmes një stuhie mendimesh, të dallojnë ose të përmendin ndryshimet që vënë re në dy fotot.

Në vijim, ai kërkon prej tyre të grupojnë ndryshimet që ata kanë identifikuar, për shembull, veshja, modeli i flokëve, numri i familjarëve etj. Mësuesi i grupon ato në tabelën e zezë.

2. Hapi i dytë (20 min.)

Mësuesi fton nxënësit në një proces leximi të orientuar.

Nxënësit lexojnë paragrafët e përcaktuara nga mësuesi dhe u përgjigjen pyetjeve të tij.

Në fillim, mësuesi ndalet në paragrafin që bën fjalë për ndryshimet që lidhen me kulturën materiale të qytetit. Mësuesi i pyet:

- Si ka ndryshuar banesa, lagjia, qyteti gjatë viteve në studim?

Në vijim, ai orienton leximin që ndihmon t'i përgjigjet pyetjes:

- Si kanë ndikuar këto ndryshime në jetën e individit?

Më tej, mësuesi ndalet në ndryshimet që lidhen me cilësitë personale të individit si për shembull, ndryshimet morale që ata kanë pësuar gjatë viteve të fundit.

Ai sqaron nxënësit që, për disa njerëz, këto ndryshime janë pozitive, të domosdoshme e në përputhje me kohën, ndërsa për disa të tjerë, këto ndryshime vlerësohen si negative, të këqija, e për rrjedhojë, janë burim të këqijash. Në këtë drejtim, mësuesi përmend konfliktin ndërmjet brezave, që në thelb është edhe konflikt ndërmjet vlerave të ndryshme. Këto ndryshime ndikojnë në veprimet e njerëzve dhe në vendimet që ata marrin në jetë. Kështu për shembull, një ndërtues e quan të drejtë dhe të moralshme që t'i japë ryshfet dikujt që i shpejton nxjerrjen e lejes së ndërtimit. Madje ai e lidh lejen e ndërtimit edhe me mundësinë e punësimit të shumë njerëzve. Të tjerë, këtë veprim e quajnë korrupsion.

Mësuesi shkruan në tabelën e zezë dy kolona. Në njërin shkruan titullin “Ndryshime pozitive” dhe në tjetrën shkruan “Ndryshime negative”. Ai fton nxënësit që të dallojnë sa më shumë ndryshime, të cilat mësuesi i vendos në kolonat përkatëse.

3. Hapi i tretë (15 min.)

Mësuesi shkruan në tabelë fjalën *korupsion* dhe kërkon nga nxënësit që të gjejnë karakteristika, cilësi, etj. të njerëzve që e mbështesin atë.

Ndërsa nxënësit japin kontributet e tyre përmes stuhisë së mendimeve, mësuesi i shpërndan ato në tabelë përreth fjalës korrupsion.

Në vijim, ai kërkon nga nxënësit të lidhin me një fjali, fjalën korrupsion me një nga karakteristikat e gjetura prej tyre, për të treguar mënyrën e lidhjes së cilësisë vetjake me dukurinë e korrupsionit.

Më pas, ai kërkon nga nxënësit të dallojnë cilësitë që mbështesin korrupsionin dhe ato që e kundërshtojnë atë.

4. Hapi i katërt (5 min.)

Reflektim.

Mësuesi fton nxënësit në një proces reflektimi duke u bërë pyetjen e mëposhtme:

- A jemi ne të gatshëm të luftojmë korrupsionin?

Mësimi 11

Lënda: Gjeografi e Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare

Klasa: XII

Tema: Mjedisi natyror dhe kushtet historiko – shoqërore për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare.

Objektivat:

Në fund të kësaj orë mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rendisë mundësitë natyrore në zhvillimin e vendit;
- të analizojë si kanë ndikuar kushtet historiko – shoqërore në zhvillimin e vendit;
- të reflektojë dhe të diskutojë për rëndësinë e faktorit njerëzor në zhvillimin ekonomik të vendit;
- të dallojë elementet e korrupsionit që lidhen me faktorin njerëzor dhe të diskutojë për pasojat e gjithanshme të tij në shoqëri.

Mjetet mësimore: teksti i nxënësit, tabelë ose tabak i madh letre, lapustila (ose shkumës)

Metoda: punë individuale dhe në grup, shpjegim

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (20 min.)

Mësuesi, në mënyrë të përmbledhur, përshkruan ndikimin e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë në zhvillimin e ekonomisë së trevave shqiptare. Më pas, ai e ndan klasën në tre grupe dhe secilit prej tyre i cakton një detyrë të veçantë. Pasi të shfrytëzojnë me kujdes informacionin e tekstit, grupet duhet t'u përgjigjen pyetjeve si më poshtë:

Grupi i parë duhet t'i përgjigjet pyetjes:

- A kanë trevat shqiptare **pasuri mjedisore** të favorshme për zhvillimin ekonomik të vendit?

Grupi i dytë duhet t'i përgjigjet pyetjes:

- Si kanë ndikuar **kushtet historiko – shoqërore** në zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare?

Grupi i tretë duhet t'i përgjigjet pyetjes:

- Si e vlerësoni ndikimin e **faktorit njerëzor**, kryesisht në dy dekadat e fundit, në ekonominë e trevave shqiptare?

Ndërsa grupet u përgjigjen pyetjeve, mësuesi i strukturon ato në tabelën e zezë, si më poshtë, duke marrë pjesë së bashku me ta në këtë detyrë.

Faktorët mjedisorë **Faktorët historiko – Faktori njerëzor në dy shoqërorë** **Faktori njerëzor në dy dekadat e fundit**

<ul style="list-style-type: none"> ➤ Pozita e favorshme gjeografike ➤ Pasuritë e mëdha nëntokësore ➤ Relievi i favorshëm ➤ Klima e përshtatshme ➤ Hidrografia e pasur ➤ Pasuria e shumëllojshme bimore e shtazor ➤ 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Luftërat e shumta ➤ Mungesa e stabilitetit politik ➤ Largimet e vazhdueshme të popullsisë, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut ➤ Firmat piramidale ➤ Korrupsioni ➤ Etj.
---	---	--

2. Hapi i dytë (15 min.)

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi kërkon nga nxënësit të përqendrohen në rolin e faktorit njerëzor në zhvillimin ekonomik të një vendi. Ai i fton ata të identifikojnë raste që shprehin rolin pozitiv ose negativ të këtij faktori në Shqipëri gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Në mënyrë të veçantë, mësuesi kërkon prej tyre të identifikojnë rastet që lidhen me aktet e korrupsionit dhe me pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të tij për individin, bashkësinë dhe kombin.

3. Hapi i tretë (15 min.)

Nxënësit ftohen të reflektojnë individualisht, për disa minuta, për mundësinë e rritjes së cilësisë së faktorit njerëzor, për ta kthyer atë vetëm në faktor pozitiv për zhvillimin ekonomik të vendit.

Pas kësaj, nxënësit ndajnë idetë e tyre me njëri-tjetrin në një proces diskutimi dhe reflektimi.

Mësimi 12

Lënda: Histori

Klasa: X

Tema: Qytetërimi më i vjetër lindi në Mesopotami.

Objektivat:

Në fund të kësaj ore mësimi, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat kryesore të qytetërimit sumer;
- të përshkruajë kontributin e qytetërimit sumer në historinë e njerëzimit, në mënyrë të veçantë, në fushën e ligjit;
- të përshkruajë kodin e Hamurabit;
- të tregojë, me argumente, që korrupsioni është një dukuri e vjetër në shoqërinë njerëzore;
- të diskutojë për disa nga format e korrupsionit që ata njohin dhe masat që duhet të merren për të luftuar ose parandaluar atë në vendin tonë ose në bashkësinë ku jetojnë.

Mjetet mësimore: teksti i nxënësit, harta e qytetërimeve botërore, kopje e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Metoda: punë individuale dhe punë me grupe.

Koha: 45 min.

Realizimi

1. Hapi i parë (20 min.)

Mësuesi e ndan klasën në dy grupe.

- Grupi i parë, pasi të lexojë mësimin me temë “Qytetërimi më i vjetër lindi në Mesopotami”, ka për detyrë të përmbledhë karakteristikat kryesore të qytetërimit sumer.
- Grupi i dytë do të përmbledhë kontributin që qytetërimi sumer ka dhënë në fushën e historisë, kryesisht në fushën e ligjeve. Në mënyrë të veçantë, ata duhet të ndalen në përshkrimin e Kodit të Hamurabit, si një prej dokumenteve më të rëndësishme të historisë.

2. Hapi i dytë (15 min.)

Në këtë fazë, mësuesi ndalet posaçërisht në Kodin e Hamurabit, si një kod i ngjashëm me ligjet e sotme, pra edhe me ligjet e Shqipërisë.

Ai fton nxënësit të lexojnë Kodin e Hamurabit dhe të identifikojnë çështjet që trajtohen në të, shkallën në të cilën mbrohet ose jo i dobëti, gruaja etj., si dhe shkeljet dhe ndëshkimet përkatëse.

Këtu, mësuesi gjen rastin të kujtojë se një ndër krimet që dënohej nga Kodi ishte kontrabanda, e cila është një dukuri aktuale dhe nënkupton, në çdo rast, edhe korrupsionin e organeve që janë përgjegjëse për kontrollin ose për luftën kundër saj.

Pas kësaj, mësuesi i fton nxënësit të flasin për dukurinë e kontrabandës në Shqipëri dhe për rastet dhe format e korrupsionit që lidhen me të.

Më tej, mësuesi thekson idenë që korrupsioni është një dukuri shoqërore, e cila ka lindur që në qytetërimet e para të njerëzimit. Në faza e në rrethana të ndryshme ai shfaqet në forma e në intensitete të ndryshme. Të ndryshme kanë qenë edhe dënimet ndaj tij.

3. Hapi i tretë (10 min.)

Diskutim dhe reflektim

- Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë për masat e mundshme që duhet të merren për të luftuar korrupsionin.
- Ai mund të trajtojë me ta edhe çështjen e ndëshkimeve ndaj akteve të korrupsionit, duke filluar me ndëshkimet që parashikoheshin në Kodin e Hamurabit dhe duke vijuar me ato që duhet të zbatohen në një shoqëri të zhvilluar demokratike etj. me qëllim pakësimin dhe uljen e tij.

Në fund të orës së mësimit, mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të shkallës në të cilën ata realizuan objektivat e orës së mësimit.

5. ANEKSE

Aneks 1: Fushat e veprimit të Strategjisë Anti-korrupsion të qeverisë shqiptare

Reduktimi i nivelit të korrupsionit nuk është një proces i lehtë dhe i shpejtë. Shtetet demokratike kanë ndërruar gjithnjë e më shumë nisma politike dhe publike për ta luftuar atë. Për këtë qëllim është krijuar edhe organizata ndërkombëtare Transparency International (TI), e cila bën hulumtime për korrupsionin në nivele të ndryshme, në shtete të ndryshme, duke zhvilluar e përhapur edhe standardet antikorrupsion.

Qeveria shqiptare ka miratuar strategjinë e saj Anti-korrupsion e cila synon të reduktojë në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme korrupsionin në sistemin politik të vendit, në ofrimin e shërbimeve publike, në mënyrën e përdorimit të parave publike, në hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike dhe sociale, në reformën e kuadrit ligjor, në sistemin shëndetësor dhe në atë arsimor.

Njohja me fushat parësore të veprimit të strategjisë antikorrupsion të qeverisë shqiptare janë ndihmë për mësuesit e edukimit kundër korrupsionit. Ato janë një burim i vlefshëm informacioni jo vetëm për të rritur cilësinë dhe efektshmërinë e veprimtarive mësimore, por edhe një bazë e mirë për të ndërtuar veprimtari të reja, në përputhje me veçoritë specifike të mjediseve arsimore dhe atyre vendore.

Çdo masë e parashikuar në fushat e veprimit të strategjisë antikorrupsion lidhet me një mjedis ose fushë konkrete në të cilën shfaqet ose mund të shfaqet korrupsioni. Në këtë mënyrë, ato mund të shërbejnë si pikënisje për eksplorime të mëtejshme nga mësuesit dhe nxënësit, për të krijuar mundësinë që edukimi kundër korrupsionit të vendoset në një kontekst konkret social, ekonomik, kulturor e politik.

Fushat e veprimit të Strategjisë Anti-korrupsion të Qeverisë Shqiptare janë:

I - SISTEMI POLITIK

- Reformimi i sistemit të financimit të partive politike në mënyrë që partitë të mos bien pre e interesave private, por t'i shërbejnë vetëm interesit publik.
- Reformimi i mëtejshëm i sistemit zgjedhor që vota e qytetareve të bëjë ndryshimin.
- Zyrtarizimi i praktikave të lobimit, në mënyrë që politikat e qeverisë të ndikohen vetëm në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.
- Reformimi i regjimit të imuniteteve, në mënyrë që personat e veshur me pushtet të ndëshkohen për aktet korruptive.

II - SHËRBIMET PUBLIKE

- Rritja e shkallës së etikës dhe profesionalizmit në administratën publike, me qëllim që taksapaguesit të marrin shërbimet që u takojnë.

- Reformimi i sistemit të liçencimit në mënyrë që të nxiten operatorët privatë ekonomikë për të hyrë në treg pa pengesa administrative.
- Reformimi i procedurave administrative në mënyrë që funksionet e administratës dhe shërbimet të kryhen në mënyrë të përshtatshme, të ndershme dhe që ankesat e qytetarëve të marrin përgjigje.
- Përsosja e mëtejshme e procesit të auditimit të brendshëm, në mënyrë që të shmangen praktikat dhe procedurat administrative të korruptuara.
- Vendosja e standardeve të shërbimeve në sektorin privat, në mënyrë që të respektohen të drejtat e qytetarëve si klientë të këtyre shërbimeve.
- Reformimi i shërbimit civil me qëllim punësimin e njerëzve të kualifikuar, që udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga interesi publik.
- Decentralizimi i ofrimit të shërbimeve publike dhe politikave kundër korrupsionit, në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimet sa më pranë vendbanimeve të tyre.
- Rritja e shkallës së transparencës, të informimit publik dhe të përdorimit të teknologjisë së informacionit nga ana e qeverisë, në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë efektive në jetën publike.

III – FINANCAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE

- Reformimi i sistemit të prokurimit, duke siguruar shërbim më të mirë për paratë e shpenzuara të taksapaguesve.
- Reformimi i procesit të hartimit të buxhetit, që qytetarët të njihen me mënyrën se si përdoren paratë e taksave dhe të sigurohen se përparësitë e qeverisë janë edhe të tyre.
- Reformimi i sistemit të doganave dhe i shërbimeve të vjeljes së taksave, në mënyrë që të garantohet liria ekonomike dhe të drejtat e taksapaguesve si konsumatorë.

IV - POLITIKAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

- Liberalizimi dhe kontrolli i tregjeve, në mënyrë që mallrat dhe shërbimet për konsumatorët të sigurohen me një kosto të arsyeshme dhe me cilësi të mirë.
- Liberalizimi i tregut të punës për rritjen e shanseve të punësimit dhe për përgatitjen e qytetarëve për tregun e punës, përmes trajnimit profesional, ndërsa i kushtohet vëmendja e duhur çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë sociale.
- Hartimi i politikave dhe strategjive për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

- Reformimi i sistemit të regjistrimit të pronës së paluajtshme, në mënyrë që të garantohet siguria juridike e pronës dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

V - REFORMA LIGJORE DHE KORRUPSIONI

- Përafrimi i legjislacionit shqiptar kundër korrupsionit me standardet më të larta dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Miratimi i politikave dhe masave për forcimin e kapaciteteve teknike dhe rritjen e shkallës së profesionalizmit të policisë për të hetuar veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe ndjekjen e pasurisë së zyrtarëve të korruptuar.
- Miratimi i politikave dhe masave për të rritur shpejtësinë dhe efikasitetin e ndjekjes penale të korrupsionit dhe të formave të tjera të krimit ekonomik.
- Miratimi i politikave dhe i masave për të siguruar meritokracinë (punësimin në bazë të meritave), profesionalizmin, paanësinë dhe statusin e gjyqtarëve, në mënyrë që të ndalet korrupsioni brenda pushtetit gjyqësor dhe vetë gjyqësori të shndërrohet në një instrument për të luftuar korrupsionin në administratën publike.
- Rritja e shkallës së bashkëpunimit të agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit me homologët e tyre të huaj në mënyrë që kriminelët, duke përfshirë zyrtarët e korruptuar, të mos t'i shmangen drejtësisë, duke lëvizur në një vend të huaj.

VI - SISTEMI SHËNDETËSOR

- Rishikimi i vazhdueshëm i listës së barnave të rimbursueshme, në mënyrë që t'i jepet përparësi nevojave të pacientëve.
- Standardizimi dhe racionalizimi i procedurave për prokurimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, në mënyrë që të sigurohet vlera më e mirë për paratë e taksave.
- Rritja e konkurrencës në tregun e kujdesit shëndetësor përmes liçencimit të furnizuesve të kujdesit shëndetësor privat, në mënyrë që qytetaret të kenë më tepër mundësi zgjedhjeje.
- Krijimi i një sistemi pagesash që eliminon shkëmbimin e drejtpërdrejtë të pagesave ndërmjet pacientit dhe mjekëve /infirmierëve.
- Rritja e shkallës së të drejtave të pacientëve dhe shqyrtimi efikas i ankesave të tyre.

VII - SISTEMI ARSIMOR

- Promovimi i etikës së vetë-rregullimit të mësuesve, duke u përqendruar veçanërisht në trajtimin e konfliktit të interesit.

- Përfshirja e prindërve, e nxënësve dhe e shoqërisë civile në marrjen e vendimeve në lidhje me politikat e arsimit, monitorimin e shpenzimeve dhe punën e institucioneve arsimore.
- Rregullimi i aktiviteteve të mësimdhënies private të mësuesve publike.
- Monitorimi dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit.

Aneks 2: Korrupsioni në legjislacionin shqiptar

1. Nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Neni 135

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën

Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 164

Shpërdorimi i kompetencave

Shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 175

Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore

(Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 48)

Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 244

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 18)

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.

Neni 245

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 19)

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.

Neni 245/1

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 20)

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtion ose siguron se është

në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, përbëjnë veprë penale dhe dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë. Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.

Neni 248

Shpërdorimi i detyrës

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 21; ndryshuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, neni 21)

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.

Neni 253

Shkelja e barazisë së shtetasve

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 256

Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti

Shpërdorimi i kontributeve, subvencioneve ose financimeve të dhëna nga shteti ose institucione shtetërore, për t'u përdorur në vepra dhe veprimtari me interes publik, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 257

Përfitimi i paligjshëm i interesave

Mbajtja, ruajtja ose marrja e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë, nga persona me funksione shtetërore apo shërbim publik, i një interesi të çfarëdoshëm në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikqyrjes, administrimit ose likuidimit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 258

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 22)

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimiti i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë.

Neni 260

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 23)

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimiti i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Neni 319

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë

(Ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 30)

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit deri në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në dy milionë lekë.

Neni 319/a

Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë

(Shtuar me ligjin nr.9275, datë 16.9.2004, neni 31)

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimiti i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë deri në katër milionë lekë.

Neni 320**Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës**

Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi a shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 328**Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve**

Ofrimi ose dhënia e të hollave, bërja e premtimeve për vende pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar pro ose kundër një kandidati apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Pranimi i të hollave, i premtimeve dhe i favorizimeve të tjera për të kryer veprimet e mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Nga ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

Konflikt i interesit

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive

2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive

3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Lloje të ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesit

4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

- a) "*konflikt faktik i interesit*" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;
- b) "*konflikt në dukje i interesit*" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;
- c) "*konflikt i mundshëm i interesit*" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje, të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;
- ç) "*konflikt rast për rast i interesit*" është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;
- d) "*konflikt i vazhdueshëm i interesit*" është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.[...]

Aneks 3: Shembuj të integritit të mësimeve në programin e Klasave 8 deri 12

Aftësi intelektuale	Prirje qytetare	Lëndët					
		Qytetari	Histori	Gjeografi	Sociologji	Filozofi	Vep. ekstrakurrikulare
Analizë, sintezë, qëndrim	Angazhim gatishmëri dhe pjesëmarrje Individualizëm apo altruizëm?	Mësues dhe nxënës: të distancuar apo të korruptuar klasa 10-11					
Identifikim, analizë shkak-pasojë, argumentim	Angazhim, gatishmëri dhe pjesëmarrje Individualizëm apo altruizëm?	Ç'ndodh kur nuk zbatohet ligji? Klasa 10					
Analizë, mendim krijues	Pjesëmarrje				Krimi i "jakave te bardha" Klasa 11		
Analizë, mendim kritik dhe krijues	Monitorim, pjesëmarrje	Ligji për konsumatorin Klasa 11					
Analizë, sintezë, qëndrim	Qëndrueshmëri, angazhim Individualizëm apo altruizëm?					Filozofia e Platonit për të mirën dhe të drejtën Klasa 12	
Analizë, sintezë, qëndrim	Monitorim, pjesëmarrje, Individualizëm apo altruizëm?	Përballimi i faktorëve pengues të demokracisë Klasa 9					
Analizë, sintezë, qëndrim, mendim krijues	Monitorim, pjesëmarrje, altruizëm, gatishmëri						Korrupsioni, shkaqet, pasojat dhe masat për parandalimin e tij
Analizë, sintezë, qëndrim	Monitorim, pjesëmarrje, altruizëm,			Problemet mjedisore në trevat			

, mendim krijues	gatishmëri			shqiptare Klasa 9			
Analizë, sintezë, qëndrim , mendim krijues	Përgjegjësi, monitorim, pjesëmarrje, altruizëm, gatishmëri	Protesta dhe demonstri met paqësore Klasa 9					
Analizë, sintezë, qëndrim , mendim krijues, shikim historik	Altruizëm, vendosmëri, vetëzhvillim	Ne ndryshoj më Klasa 8					
Analizë, sintezë, Reflektim kritik, Mendim krijues	Monitorim, pjesëmarrje, altruizëm, gatishmëri vetëzhvillim			Mjedisi natyror dhe kushtet historiko – shoqërore për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare. Klasa 12			
Analizë, sintezë, qëndrim mendim krijues, shikim historik			Qytetërimi më i vjetër lindi në Mesopotami Klasa 10				

Literaturë shtesë për luftën kundër korrupsionit - Për ata që duan të dinë më shumë...

- CRIMINAL LAW CONVENTION ON CORRUPTION, Strasbourg, 27.I.1999
- EUROPEAN CONVENTION ON THE EXERCISE OF CHILDREN'S RIGHTS, Strasbourg, 25.I.1996
- CIVIL LAW CONVENTION ON CORRUPTION, Strasbourg, 4.XI.1999
- ADDITIONAL PROTOCOL TO THE CRIMINAL LAW CONVENTION ON CORRUPTION, Strasbourg, 15.V.2003
- ANTI-CORRUPTION EDUCATION AT SCHOOL- METHODOICAL MATERIAL FOR GENERAL AND HIGHER EDUCATION SCHOOLS, botim i Qendrës së didaktikës moderne (Modern Didactic Centre), Lituani, 2006
- EDUKIMI ANTI-KORRUPSION NË SHKOLLAT E MESME, botim i Qendrës për Arsim e Kosovës (KEC), Prishtinë, 2006
- Kodi Penal i Shqipërisë, i azhurnuar deri ne tetor 2004
- Ligji shqiptar për konfliktin e interesit, Nr. 9367, datë 7.4.2005

Ky manual është hartuar dhe botuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet e shprehura në të nuk duhet të interpretohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Edukimi kundër korrupsionit

Manual për mësuesit